



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA
REGULATORNI URED ZA VODU I OTPAD
WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE



DEPARTAMENTI PËR FINANCA DHE TARIFA RREGULLATORE

RAPORT VJETOR SEKTORIAL I KRU-VE
mbi
PËRMBUSHJEN E CAQEVE TË PËRCAKTUARA
ME PROCESIN RREGULLATORË
TË VITIT 2009

PERIUDHA RAPORTUESE:
JANAR - DHJETOR, 2009

Gusht 2010

Vizioni për një kompani të suksesshme

“Ekstrakto ujin aq sa ka nevojë, racionalizo prodhimin, minimizo humbjet, racionalizo shpenzimet - por jo në dëm të shërbimit, distribuo në mënyrë racionale ujin e ekstraktuar, faturo vetëm sasinë e ujit të furnizuar, përdor të gjitha mënyrat dhe metodat e lejueshme legale për të ngritë shkallën e inkasimit dhe inkaso shuma maksimale të mundshme”

DFTRR/ZRRUM, 2010

Parathënie

Ky raport paraqet një pasqyrë të të dhënave dhe treguesve kryesor; operativ, financiar dhe atyre të investimeve kapitale, për shtatë (7) Kompanitë Regjionale të Ujit (KRU), të realizuara nga to, në periudhën; nga 1 janar gjerë me 31 dhjetor 2009. Analizat në këtë raport mbështetën në krahasimin e të dhënave të realizuara nga kompanitë me caqet e përcaktuara me procesin rregullatorë të tarifave të vitit 2009-2011, për vitin e përmbyllur 2009. Qëllimi i këtij raporti është i trefishtë:

- (i) Të jepet një informacion për shkallën e përbushjes së caqeve të përcaktuara me procesin rregullatorë të vitit 2009, sikurse janë të dhënat; operative, financiare dhe ato të investimeve kapitale të KRU-ve dhe sektoriale, që do ti shërbejnë si informacion ZRRUM-it dhe palëve tjera të interesit;
- (ii) Të krahasohen treguesit e Caqeve të Përcaktuara me Procesin Rregullatorë (CPPRR) për çdo kompani me objektivat e përcaktuara në planet e tyre të biznesit dhe në rast të shmangieve të tyre, Planet e Bizneseve (PB) të përshtaten me caqet e procesit tariforë gjatë vitit të mbetur 2011;
- (iii) Analizat e të dhënave të tilla do të jenë udhërrëfyes për angazhim të mëtutjeshëm të DFTRR/ZRRUM, për vitet e mbetura tarifore 2010-2011, nga procesi trevjeçarë tariforë 2009-2011 dhe në veçanti efektet e ndikimit të tarifave në realizim të projekteve investive kapitale me financim të brendshëm financiarë, etj.

Prezantimi i të dhënave në këtë raport përmbledh tri shtylla kryesore: a) të dhënat e realizuara të vitit 2008, b) të dhënat e aprovuara me marrëveshje KRU – ZRRUM për vitin 2009, dhe c) të dhënat e arritur nga kompanitë gjatë gjithë vitit 2009.

Të dhënat për këtë raport janë si rezultat i të dhënave të rregullta të mbledhura nga sistemi i Raportit Financiarë Operativë të Konsumatorëve (RFOK) në Departamentin e Përformancës (DP) dhe nga auditimi i të dhënave të mbledhura gjatë muajt prill – maj 2010, të cilin e ka realizuar ekipi i autorizuar i ZRRUM-it për vitin 2010.

Me konkluzionet e këtij raporti do të njoftohen përfaqësuesit e kompanive dhe palët tjera të interesit.

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	5
2. ASPEKTET ADMINISTRATIVE	6
3. METODOLOGJIA TARIFORE	6
4. IDENTIFIKIMI I TË DHËNAVE DHE TREGUESVE OPERATIV, FINANCIAR DHE INVESTIV	8
<i>4.1. ANALIZA E PRODHIMIT DHE FATURIMIT SASIOR</i>	<i>10</i>
4.1.1. TË DHËNAT E PRODHIMIT DHE FATURIMIT SASIOR SIPAS KRU-ve.....	11
4.1.2. PARAQITJA GRAFIKE E TË DHËNAVE SASIORE PËR UJIN E PRODHUAR DHE TË FATURUAR TE KRU-TË.....	15
4.1.3. TË DHËNAT SEKTORIALE PËR PRODHIM, HUMBJE DHE FATURIM TË SASISË SË UJIT.....	18
<i>4.2. ANALIZA E SHPENZIMEVE OPERATIVE</i>	<i>21</i>
4.2.1 SHPENZMET OPERATIVE SIPAS KRU-ve	22
4.2.2. PARAQITJA GRAFIKE E TË DHËNAVE PËR SHPENZIME OPERATIVE PËR KRU-TË.....	26
4.2.3 SHPENZMET OPERATIVE NË NIVEL TË SEKTORIT	27
<i>4.3. ANALIZA E FATURIMIT DHE INKASIMIT</i>	<i>29</i>
4.3.1. FATURIMI DHE INKASIMI SIPAS KRU-ve	30
4.3.2. PARAQITJA GRAFIKE E TË DHËNAVE TË FATURIMIT DHE INKASIMIT TË KRU-TË.....	34
4.3.3. FATURIMI DHE INKASIMI NË NIVEL TË SEKTORIT	36
<i>4.4. ANALIZA E INVESTIMEVE KAPITALE</i>	<i>39</i>
4.4.1 INVESTIMET KAPITALE SIPAS KRU-ve	42
4.4.2. TË DHËNAT SEKTORIALE TË PËRGJITHSHME PËR INVESTIME KAPITALE	47
5. KONKLuzionET DHE REKOMANDIME	49

1. HYRJJE

Përmbyllja e vitit të parë të procesit rregullatorë afatmesëm tre (3) vjeçar 2009-2011 të përcaktimit të tarifave, pas 2 proceseve një vjeçare rregullatorë për Kompanitë e Regjionale të Ujit (KRU) të vendit, është me interes shumë të madh për të parë shkallën e përbushjes së caqeve të përcaktuara me procesin e vitit 2009 dhe perspektiven e përbushjes së tyre gjerë në fund të vitit 2011.

Këto arsye kanë parashtruar nevojën e monitorimit të efekteve të arritura me tarifatat e reja tre vjeçare.

Të dhënat e dala do të jenë tregues shumë të dobishëm me të cilët do të shohim të arriturat e këtij sektori në frymën e përbushjes së obligimeve të marra nga kompanitë, për ti realizuar objektivat e caktuara në fund të çdo viti kalendarik, duke filluar nga viti i parë i vlefshmërisë së tarifave të këtij procesi rregullatorë e që është ai i vitit 2009.

Në vazhden e shtimit të obligimeve dhe detyrave të Departamentit të Financave dhe Tarifave Rregullatore (DFTRR), i cili vepron në kuadër të ZRRUM-it, është paraqitur nevojë imediate e këtij departamenti për të planifikuar edhe detyra shtesë për të përpiluar raporte periodike dhe atë vjetore, për të pasqyruar përbushjen e caqeve të përcaktuara me procesin e fundit të përcaktimit të tarifave.

Ky plan i punës ka mundësuar ndërmarrjen e veprimeve të duhura për të mbledhur, përpunuar, analizuar dhe raportuar të dhënat dhe efektet e tyre për vitin 2009, pasi që të njëjtat kanë qenë në përgjithësi më të larta se ato të procesit paraprak rregullatorë, pas aplikimit të një politike dhe metodologjie rregullative.

Për përgatitjen e një raporti të tillë, gjithëpërfshirës mbi ndikimin e tarifave në zhvillimin dhe avancimin e afarizmit të KRU-ve, të licencuara për shërbimet e ujit, jemi mbështetur edhe në ndihmën dhe bashkëpunimin e KRU-ve, për çka i falënderojmë.

Përveç se kemi marrë të dhëna të rregullta mujore të raportuara sipas projektit të ROFK-ës i cili mbahet në DP/ZRRUM, kemi pas edhe vizita individuale gjatë dhe pas përpilimit të dy raporteve të para periodike të vitit 2009, të cilat kanë rezultuar me përmbylljen e këtij raporti përmbledhës.

Për këtë qëllim ne kemi përpiluar formate të caktuara të pyetësorëve me të cilët janë marrë të dhënat dhe mbledhur shënimet për një grup të të dhënave dhe treguesve kryesorë operativ-financiarë dhe ato të investimeve kapitale të realizuara në periudhën e trajtuar një vjeçare, të vitit 2009.

Analizat e veçanta për secilën kompani janë pasqyruar në formë tabelore, sikurse janë analizuar dhe komentuar më detajisht në vijim të këtij raporti.

2. ASPEKTET ADMINISTRATIVE

Analiza dhe monitorimi i të dhënave dhe treguesve kryesorë operativë financiarë të KRU-ve të përcaktuar me procesin rregullatorë 2009-2011 është mbështetur në Ligjin Nr. 03/L-086, *Mbi Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2004/49, për Veprimtaritë e Shërbimeve të Ujësjetësve, Kanalizimeve dhe të Mbeturave*, dhe të Rregullës R-02/U&K, e datës 12.08.2008, *Për Përcaktim të Tarifave të Shërbimit për Shërbimet e Ujësjetësit, Ujërave të Zeza, dhe të Furnizimit të Ujit me Shumicë në Kosovë*, neni 26, pika a. dhe b.

Bazuar në aktet legjislative të theksuara më lartë, ndërmarrja e një aktiviteti monitorues është përcaktuar edhe me Politikën Tarifore për Shërbimet e Ujit të nxjerrë nga ZRRUM në shtator 2007, si dhe me Planin e Punës për Vitin 2009 (pikat (ii) të DFTRR-ës, synimi V, nga pika (i) gjerë te pika (vii), Raportet e veçanta përfundimtare të vlerësimit për përcaktim të tarifave afatmesme 2009–2011.

Identifikimi i efekteve të tarifave në caqet e përcaktuara për të arrit të dhëna dhe treguesve të tillë operativ-financiarë dhe ato të investimeve kapitale për vitin 2009 dhe për dy vitet tjera vijuese, është vendimtar për aktivitetet e mëtutjeshme të vet kompanive; si në ngritjen e nivelit të shërbimit dhe efikasitetin më të mirë, me çka realizohen synimet e tyre dhe të ZRRUM-it, të cilat janë të ndërlidhura me interesin e përgjithshëm shoqëror.

Për ti përbushur synimet, DFTRR-ja do të përpilojë politika dhe aplikojë metodologji të reja, të avancuara për të ngritur nivelin e shërbimit dhe për të mbrojtur interesin e konsumatorëve, por jo në dëm të kompanive.

Me identifikimin e ndikuesve të brendshëm ose të jashtëm në afarizmin e kompanive dhe ndërmarrjen e masave për tu përshtatur të njëjtave (me arsye të bazuar) do të ndihmojmë përmirësimin e Performancës së KRU-ve, e cila duhet të bëhet me ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për korrigjim të politikave dhe caqeve të përcaktuara me tarifën e përcaktuara për vitin e mbetur tariforë 2011 nga ky proces.

Nga aspekti administrativ DFTRR/ZRRUM mund të ndërmerr veprime të caktuara administrative me qëllim të përshtatjes së rrethanave të reja të krijuara nga procesi rregullatorë, të cilat mund të jenë ndikuar nga faktorët e theksuar në këtë publikim.

Të gjitha veprimet eventuale që mund ti ndërmarr ZRRUM, do të jenë në pajtim me rrethanat apo situatat e caktuara që mund të paraqiten dhe të njëjtat do të ndërmerren pas konsultimeve të ndërsjella me palët e interesit.

3. METODOLOGJIA TARIFORE

Politika dhe metodologjia e përdorur për përcaktim të tarifave 2009-2011, dallon nga ajo e përdorur në dy proceset tjera paraprake. Për këtë qëllim DFTRR/ZRRUM ka pas mbështetjen e konsulentëve ndërkombëtar me ç'rast janë zhvilluar metodologji të reja tarifore, bazuar në praktikën e mira të rregullatorëve tjerë ekonomik të shërbimeve të ujit, sikurse që janë ato të shteteve të Britanisë së Madhe, duke pasur parasysh specifikat tona aktuale.

Kjo metodologji bazohet në kategoritë vijuese:

- (i) mbulimin e shpenzimeve operative dhe atyre të investimeve kapitale,
- (ii) marrjen parasysh të shumës së amortizimit për asetet jo-infrastrukturore,
- (iii) përcaktimin e vlerës Rregullatore të kapitalit,
- (iv) normën e kthimit në vlerën Rregullatore të kapitalit,
- (v) fillimin e mbajtjes së kontabilitetit rregullator për çdo kosto qendër veç e veç, me theks të veçantë te shërbimet e ujësjellësit dhe atë të kanalizimit, etj.

Përdorimi i disa kategorive të reja ekonomike ka ndikuar që edhe politikat tarifore të ZRRUM-it të ndryshojnë dhe ti përshtaten rrethanave të reja të cilat i kërkon koha duke theksuar edhe monitorim periodik të lëvizjeve ekonomike të të dhënave dhe treguesve kryesorë të KRU-ve. ZRRUM do të përcjell në vazhdimësi ndikimin e tarifave të përcaktuara edhe për periudhën e mbetur dy vjeçare 2010-2011, të cilat do të vazhdojnë të monitorohen me vizita të kohëpaskohshme nëpër kompani dhe nxjerrjen e të dhënave të mbledhura nga DP/ZRRUM nga raportimet që i bëjnë KRU-të sipas projektit të RFOK-së.

Kalimi nga sistemi i përcaktimit të tarifave 1-vjeçare në atë 3-vjeçare ka ndikuar në ndërrimin e metodologjisë së përcaktimit të tarifave që llogaritet si pikë kthese për fillimin e realizimit të investimeve kapitale për:

- (i) sigurimin e burimeve të reja me ujë,
- (ii) zëvendësimi dhe zgjerim të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit,
- (iii) ngritjen e nivelit të shërbimit,
- (iv) të ndikuar në ngritjen e vazhdueshme të qëndrueshmërisë financiare të vet kompanive etj.

Metodologjia e përcaktimit të tarifës bazohet mbi vlerën e tarifës e cila duhet të jetë e barabartë ose më e lartë se shuma e shpenzimeve operative dhe të atyre të investimeve të pjesshme kapitale, duke shikuar edhe mundësinë e pagesës së faturave që KRU-të u dërgojnë për pagesë konsumatorëve të vet.

Procesi tariforë zhvillohet duke marrë parasysh kostot operative-financiare, nga të cilat po numërojmë:

- (i) kostot e kaptimit të ujit,
- (ii) kostot e prodhimit dhe shpërndarjes së ujit të pijes,
- (iii) kostot e grumbullimit të ujërave të zeza,
- (iv) kostot e personelit,
- (v) kostot e riparimit dhe të mirëmbajtjes,
- (vi) investimet e reja në infrastrukturën nëntokësore dhe mbi tokësore,
- (vii) amortizimin e aseteve jo-infrastrukturore,
- (viii) përcaktimin e vlerës Rregullatore të kapitalit,
- (ix) llogaritjen e normës së kthimit në kapital etj.,

që të gjitha këto futen në proporcion me sasinë e ujit të prodhuar dhe shkallën e planifikuar të inkasimit.

Me procesin rregullatorë të vitit 2009 -2011, për secilën prej KRU-ve janë përgatitur pasqyrat e të hyrave të planifikuara në bazë të parasë së gatshme, ku është llogaritur edhe profiti i mundshëm në fund të çdo viti afarist, të cilin profit KRU-të duhet ta investojnë për ta zgjeruar bazën e tyre materiale, me të dhënat e planifikuara të cilat janë akorduar me ZRRUM-in.

Edhe më parë, vazhdimisht kemi theksuar se me mos përmbushja e planeve të investimeve kapitale, të cilat në vete përmbajnë profitin e kompanisë e të cilat kanë afektuar tarifën e përcaktuara, mund të ketë si pasojë rishikimin e tarifave për vitet pasuese, pasi që mund të konsiderohet se pa të drejtë

janë ngarkuar konsumatorët me një pjesë të tarifës e cila nuk po përdoret për qëllimin e parapërcaktuar.

Zgjerimi i bazës së kostove të reja të cilat e kanë ngarkuar tarifën, sikurse u theksua edhe më lartë, i jep të drejtë KRU-ve që mjetet e fituara financiare ti përdorin për investime kapitale, sikurse edhe ato të tjerat të huazuara mbi bazën e kredive komerciale, etj.

Këto veprime merren në koordinim të ngushtë me menaxhmentët e KRU-ve (duke saktësuar afatet kohore paraprake, metodologjinë, treguesit) dhe përmbylljen e proceseve të tilla me përpilimin e raporteve periodike dhe vjetore.

Përmes monitorimit dhe analizimit të këtyre lëvizjeve tentohet të parandalohen ndikimet eventuale negative që mund të jenë shkaktarë të mosrealizimit të planeve të kompanive gjatë periudhës së mbetur 2-vjeçare dhe të ndërmerren veprime adekuate korigjuese në pajtim me rrethanat e reja të krijuara.

4. IDENTIFIKIMI I TË DHËNAVE DHE TREGUESVE OPERATIV, FINANCIAR DHE INVESTIV

Treguesit e identifikuar si kryesorë të cilët janë marrë dhe do të merren në konsideratë për tu analizuar dhe monitoruar gjatë vlefshmërisë së tarifave ekzistuese për këtë proces rregullatorë, do të dalin nga të dhënat e tilla të aprovuara në marrëveshje me kompanitë dhe ato të realizuara nga të njëjtat gjatë vitit 2009, të krahasueshme edhe me vitin 2008.

Grupimet e treguesve të identifikuar, janë:

- (i) sasia e ujit të prodhuar,
- (ii) sasia e ujit të faturuar,
- (iii) vlera monetare e faturimit,
- (iv) shuma e inkasimit,
- (v) shuma e shpenzimeve operative,
- (vi) shuma e projekteve të planifikuara dhe realizuara gjatë vitit 2009, etj.

Në vijim do të pasqyrojmë të dhënat në formë tabelore për çdo KRU veç e veç dhe në fund të dhënat e tilla do ti përmbledhim si të përbashkëta për sektorin, me qëllim të krijimit të një pasqyre të plotë. Të njëjtat do ti ofrojmë edhe në formë grafike, dhe do të komentohen në pika të veçanta dhe të përgjithshme.

Shënim: Të dhënat e zbrazëta në pasqyrat e këtij raporti janë si rezultat i mungesës së të dhënave të marra nga kompanitë.

**TË DHËNAT DHE GJETJET E TYRE PËR ;
UJIN E PRODHUAR, UJIN E HUMBUR,
UJIN E FATURUAR DHE
UJËRAT E ZEZA TË GRUMBULLUARA**

4.1. ANALIZA E PRODHIMIT DHE FATURIMIT SASIOR

Të dhënat e mbledhura për këtë grupim dhe të tjerat, do ti paraqesim në formë tabelore të thjeshtësuar, me qëllim të krahasimit më të lehtë dhe verifikim ma të lehtë të tyre.

Konkluzionet e nxjerra për kompanitë individuale do të jenë udhërrëfyes për përmirësim të performancës së tyre gjatë vitit 2010 – 2011.

Tabela Nr. 1 Të dhënat sasiore për ujin e prodhuar, ujin e humbur dhe të dhënat e ujërave të faturuara për vitin 2009

Nr.	Emrtimi i KRU-ve	Të dhënat	Njës. mat.	Historike DP/ZRRUM 2008	Aprovuara nga ZRRUM 2009	Realizuar nga KRU të 2009
1	"Prishtina" Sh.A. Prishtinë	Uji i prodhuar	m ³	40,832,446.67	44,628,000.00	45,105,379.00
		Uji i humbur		18,978,558.67	19,971,029.33	24,214,078.00
		Uji i faturuar		21,853,888.00	24,656,970.67	20,891,301.00
		Ujërat e zeza të faturuara		17,401,439.00	20,958,424.00	18,024,492.09
2	"Mitrovica" Sh.A. Mitrovicë	Uji i prodhuar	m ³	16,806,031.00	16,580,000.00	17,358,593.00
		Uji i humbur		8,370,529.00	7,278,038.67	8,895,248.00
		Uji i faturuar		8,435,502.00	9,301,961.33	8,463,345.00
		Ujërat e zeza të faturuara		4,203,189.00	4,300,247.00	3,890,980.00
3	"Hidrodrini" Sh.A. Pejë	Uji i prodhuar	m ³	30,365,646.00	30,000,000.00	28,192,459.00
		Uji i humbur		22,628,310.00	22,574,878.50	20,908,029.00
		Uji i faturuar		7,737,336.00	7,425,121.50	7,284,430.00
		Ujërat e zeza të faturuara		2,932,003.00	3,118,551.00	3,531,182.00
4	"Radoniq" Sh.A. Gjakovë	Uji i prodhuar	m ³	17,047,774.00	17,757,802.00	15,162,287.00
		Uji i humbur		10,651,055.00	8,956,302.00	8,366,236.00
		Uji i faturuar		6,396,719.00	8,801,500.00	6,796,051.00
		Ujërat e zeza të faturuara		4,482,258.00	4,884,832.00	1,186,142.00
5	"Hidroregjioni Jugor" Sh.A. Prizren	Uji i prodhuar	m ³	12,558,975.00	12,057,815.00	15,244,976.00
		Uji i humbur		5,545,839.00	4,302,885.67	8,420,885.00
		Uji i faturuar		7,013,136.00	7,754,929.33	6,824,091.00
		Ujërat e zeza të faturuara		6,943,062.00	7,134,535.00	6,278,163.73
6	"Bifurkacioni" Sh.A. Ferizaj	Uji i prodhuar	m ³	3,873,580.00	5,942,235.00	5,088,640.00
		Uji i humbur		1,839,864.00	2,696,908.33	2,910,484.00
		Uji i faturuar		2,033,716.00	3,245,326.67	2,178,156.00
		Ujërat e zeza të faturuara		2,231,628.00	2,596,262.00	1,742,525.25
7	"Hidromorava" Sh.A. Gjilan	Uji i prodhuar	m ³	5,847,896.00	8,870,000.00	6,937,500.00
		Uji i humbur		2,860,619.00	5,533,595.00	3,954,319.00
		Uji i faturuar		2,987,277.00	3,336,405.00	2,983,181.00
		Ujërat e zeza të faturuara		3,395,459.00	3,002,764.00	2,684,862.45
Të dhënat përmbledhëse të sektorit		Uji i prodhuar	m ³	127,332,348.67	135,835,852.00	133,089,834.00
		Uji i humbur		70,874,774.67	71,313,637.50	77,669,279.00
		Uji i faturuar		56,457,574.00	64,522,214.50	55,420,555.00
		Ujërat e zeza të faturuara		41,589,038.00	45,995,615.00	37,338,347.53

Në vijim po i analizojmë shkurtimisht të dhënat e këtij grupimi të deklaruar për çdo kompani veç e veç dhe në fund të njëjtat po i komentojmë nga perspektiva e ZRRUM-it, duke ofruar edhe sugjerimet tona eventuale për përbushje të planave të përcaktuara në të ardhmen.

4.1.1. TË DHËNAT E PRODHIMIT DHE FATURIMIT SASIOR SIPAS KRU-ve

- **KRU "PRISHTINA" Sh. A. Prishtinë**

KRU "Prishtina" Sh. A. Prishtinë, nga katër treguesit operativë të theksuar te Tabela. Nr. 1, të shikuar nga aspekti i përbushjes së caqeve të përcaktuar me proces rregullatorë për vitin 2009 e ka përbushur dhe tejkaluar vetëm sasinë e ujit të prodhuar gjatë vitit 2009 për 1,07%, ndërsa tre treguesit tjerë i ka negativ dhe si rezultat i kësaj edhe treguesi i ujit të prodhuar del të jetë i pa efektshëm. Të dhënat të cilat e dëshmojnë këtë janë;

1. Sasia e ujit të humbur është ngritë nga sasia e aprovuar nga ZRRUM për vitin 2009 për 21,25%, dhe
2. Sasia e ujit të faturuar është më e ulët sesa sasia e aprovuar me procesin rregullatorë për vitin e njëjtë për 15,27%, dhe
3. Sasia e ujërave të zeza po ashtu ka dështuar të përbushet në krahasim me cakun e përcaktuar gjatë vitit të parë të procesit rregullatorë të vitit 2009 për 14,00%

Edhe pse nuk janë çështje të analizave tona vitet krahasuese 2008 me atë të përmbyllur të vitit 2009, duhet theksuar se;

- (i) sasinë e ujit të prodhuar kjo kompani e ka tejkaluar 10,46%,
- (ii) sikurse që ka tejkaluar edhe sasinë e grumbullimit të ujërave të zeza për të njëjtën periudhë të shikuar prej 3,58%

Ndërsa kur të krahasohen edhe të dhënat e faturimit për të njëjtën periudhë kohore (2008/2009) shohim se kompania ka dështuar ti përbush dy treguesit tjerë kryesorë;

- (i) humbja e ujit është më e lartë gjatë vitit 2009 se ajo e vitit 2008 për 27.59%, dhe
- (ii) faturimin e sasisë së ujit e ka më të ulët gjatë vitit 2009 se atë të vitit 2008 për 4,40%,

Nëse komentohen të dhënat e përgjithshme për këtë kompani shohim se kompania ka dështuar ti përbush caqet e përcaktuara për faturim dhe zvogëlim të humbjeve dhe me këta tregues, prodhimi i ujit nuk është më tregues pozitivë por e kundërta e tij.

Në përgjithësi kompania ka dështuar të i përbush të dhënat e këtij grupimi. Angazhimi i saj duhet të drejtohet te përbushja e caqeve të përcaktuara me proces rregullatorë tani për vitin 2010 dhe 2011, të dhënat e të cilave do të monitorohen dhe raportohen në tri raportet e radhës.

- **KUR "MITROVICA" Sh. A. Mitrovicë**

Edhe kjo kompani nga katër treguesit operativë të theksuar tek Tabela. Nr. 1, të shikuar nga aspekti i përbushjes së caqeve të përcaktuara me proces rregullatorë për vitin 2009 ka përbushur dhe tejkaluar vetëm sasinë e ujit të prodhuar gjatë vitit 2009 për 4,70%, ndërsa tre treguesit tjerë i ka negativë dhe si rezultat i kësaj edhe treguesi i ujit të prodhuar del të jetë i pa efektshëm. Të dhënat që dëshmojnë këtë janë;

1. Sasia e ujit të humbur është rritur nga sasia e aprovuar prej ZRRUM për vitin 2009 për 22,22%, dhe
2. Sasia e ujit të faturuar është më e ulët se sasia e aprovuar me procesin rregullatorë për të njëjtin vit për 9,02%, dhe
3. Sasia e ujërave të zeza të grumbulluara po ashtu është e pa përbushur në krahasim me cakun e përcaktuar me procesin rregullatorë për 9,52% .

Edhe te kjo kompani do të krahasohen të dhënat e përmbyllura të vitit 2008 me ato të vitit 2009, për çka duhet theksuar se;

- (i) sasia e ujit të prodhuar te kjo kompani është tejkaluar për 3,29% gjatë vitit 2009 në krahasim me vitin e shikuar 2008, dhe

- (ii) ka ulje të sasisë së ujërave të zeza të grumbulluara për të njëjtën periudhë për 7,43%

Ndërsa kur të krahasohen të dhënat e faturimit për të njëjtën periudhë kohore (2008/2009) shohim se kompania ka dështuar ti përmbush dy treguesit tjerë kryesorë;

- (i) humbja e ujit është më e lartë gjatë vitit 2009 nga ajo e vitit 2008 për 6.27%, dhe
- (ii) faturimin e ka më të lartë gjatë vitit 2009 se ai i vitit 2008 për vetëm 0,33%,

Nëse komentohen të dhënat e përgjithshme të shikuara të kësaj kompanie për vitin 2009, shohim se kompania ka dështuar ti përmbush caqet e përcaktuara për faturim të ujit dhe grumbullim të ujërave të zeza, sikurse që ka dështuar ti zvogëloj edhe humbjet e ujit të prodhuar. Rritja e sasisë së ujit të prodhuar gjatë vitit 2009 në krahasim me cakun e përcaktuar, nuk mund të llogaritet më si tregues pozitivë por është e kundërta e tij.

Në përgjithësi kompania ka dështuar ti përmbush të dhënat e këtij grupimi. Angazhimi i saj duhet të drejtohet te përmbushja e caqeve të përcaktuara me proces rregullatorë tani për vitin 2010 dhe 2011, të dhënat e të cilave do të monitorohen me tri raporte vijuese të vitit 2010.

- **KRU "HIDRODRINI" Sh. A. Pejë**

Edhe KUR "Hidrodrini" Sh. A. Pejë, nga katër treguesit operativë të theksuar te Tabela. Nr. 1, të shikuar nga aspekti i përmbushjes së caqeve të përcaktuara me proces rregullatorë për vitin 2009, ka përmbushur dhe tejkaluar vetëm sasinë e ujërave të zeza të grumbulluara gjatë vitit 2009 për 13,23%, si dhe një përmirësim të lehtë sa i përket humbjeve të ujit, ndërsa dy treguesit tjerë i ka negativë, Sasia e ujit të prodhuar gjatë vitit 2009 është më e ulët se ajo e përcaktuar si cak me proces rregullatorë për 6,03%,

1. Sasia e ujit të humbur është më e ulët se ajo e përcaktuar me proces rregullatorë për vitin 2009 për 7.38%, mirëpo kjo rënie ka ndodhur si pasojë e zvogëlimit të sasisë së ujit të prodhuar e cila në fakt tregon se kjo kompani ka përmirësim të lehtë të humbjeve të ujit. Kjo ndodh për arsye se sipas procesit rregullator është paraparë që humbjet të jenë 75.25 % krahasuar me sasia e ujit të prodhuar, ndërsa Kompania sipas të dhënave të audituara ka 74.16 % humbje të ujit në krahasim me ujin e prodhuar.
2. Sasia e ujit të faturuar është më e ulët se sa sasia e aprovuar me procesin rregullatorë për vitin 2009 për 1,89%

Edhe në këtë rast do të bëjmë analiza krahasuese për të dhënat e vitit 2008 me ato të përmbyllura të vitit 2009, për çka duhet theksuar se;

- (iii) sasia e ujit të prodhuar te kjo kompani është më e ulët gjatë vitit 2009 për 7,16% në krahasim me vitin e shikuar 2008, dhe
- (iv) ka ngritje të sasisë së ujërave të zeza të grumbulluara për të njëjtën periudhë për 20,44%.

Ndërsa kur të krahasohen dy treguesit të tjerë kemi, këto të dhëna;

- (iii) humbja e ujit është më e ulët gjatë vitit 2009 nga ajo e vitit 2008 për 7.6%, por edhe prodhimi gjatë vitit 2009 është më i ulët dhe kështu relativizohet ky tregues,
- (iv) faturimi ka qenë po ashtu më i ulët gjatë vitit të shikuar 2009 se ai i vitit 2008 për 5,85%,

Nëse komentohen të dhënat e përgjithshme të shikuara të kësaj kompanie për vitin 2009, shohim se kompania ka dështuar ti përmbush caqet e përcaktuar për prodhim të ujit dhe faturim të tij, përpos që ka treguar përmirësim të lehtë në uljen e humbjeve të ujit, ndërsa ka ngrit sasinë e grumbullimit të ujërave të zeza, në përgjithësi treguesit negativ të paraqitur gjatë këtij viti nuk janë tregues shpresëdhënës për vitin 2010 dhe 2011.

Për këto të dhëna duhet theksuar se kompania pjesërisht ka përmbush të dhënat e këtij grupimi, të cilat nuk janë të mjaftueshme. Angazhimi i saj duhet tani e tutje të drejtohet në përmbushjen e

caqeve të përcaktuara me procesin rregullatorë të vitit 2010 e 2011, të dhënat e të cilave do të monitorohen gjatë këtij viti.

- **KRU "RADONIQI" Sh. A. Gjakovë**

Kjo kompani nga katër treguesit operativë të theksuar te Tabela. Nr. 1, të shikuar nga aspekti i përbushjes së caqeve të përcaktuara me proces rregullatorë për vitin 2009 e ka pozitivë vetëm atë të sasisë së ujit të humbur e cila është më e ulët për 6,59% në krahasim me sasinë e lejuar si humbje për vitin e shikuar, mirëpo edhe ky tregues si i tillë nuk është pozitiv kur i njëjti krahasohet me sasinë e ujit të prodhuar gjatë vitit 2009. Mos përbushja e treguesve të tjerë konsiston në këtë, pasi që;

1. Sasia e ujit të prodhuar gjatë vitit 2009 është më e ulët se ajo e përcaktuar si cak me proces rregullatorë për 14,62%,
2. Edhe sasia e ujit të humbur është më e ulët se ajo e përcaktuar me proces rregullatorë për vitin 2009 për 6,59%, mirëpo bazuar në sasinë e ujit të prodhuar humbjet e ujit të lejuara për vitin 2009 janë përcaktuar 50 % ndërsa humbjet e ujit të realizuara gjatë vitit 2009 duke u bazuar në sasinë e ujit të prodhuar janë 55 % gjë që tregon se kompania nuk ka treguar efikasitet gjatë këtij viti për këtë çështje.
3. Sasia e ujit të faturuar është më e ulët se sa sasia e aprovuar me procesin rregullatorë për vitin 2009 për 22,79%

Edhe në këtë rast do të analizohen të dhënat e vitit krahasues 2008 me vitin e përmbyllur 2009, për çka duhet theksuar se;

- a) sasia e ujit të prodhuar te kjo kompani është më e ulët gjatë vitit 2009 për 11,06% në krahasim me vitin e shikuar 2008,
- b) kurse ka ulje të sasisë së humbjeve të ujit gjatë vitit 2009 për 21,45% në krahasim me të dhënë e tillë gjatë vitit 2008.

Ndërsa kur të krahasohen dy treguesit të tjerë kemi këto të dhëna;

- a) faturimin e ka më të lartë gjatë vitit të shikuar 2009 se ai i vitit 2008 për 6,24%,
- b) ndërsa faturimin e ujërave të zeza të grumbulluara e ka më të ulët për 73,54% gjatë vitit 2009 në krahasim me vitin 2008.

Nëse komentohen të dhënat e përgjithshme të shikuara të kësaj kompanie për vitin 2009, shohim se kompania ka dështuar me përbush caqet e përcaktuara për prodhim të ujit, faturim të ujit dhe ujërave të zeza të grumbulluara dhe sasinë e ujërave të humbura, në përgjithësi të dhënat e tilla nuk janë tregues shpresëdhënës për vitin 2010 dhe 2011.

Prandaj, duhet theksuar se kompania ka dështuar me i përbush treguesit kryesorë të këtij grupimi. Angazhimi i saj duhet tani e tutje të drejtohet në përbushjen e caqeve të përcaktuara me procesin rregullatorë të vitit 2010 e 2011, të dhënat e të cilave do të monitorohen gjatë këtij dhe vitit tjetër.

- **KRU "HIDROREGIJONI JUGOR" Sh. A. Prizren**

Edhe KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh. A. Prizren nga katër treguesit operativë të theksuar te Tabela. Nr. 1, të shikuar nga aspekti i përbushjes së caqeve të përcaktuara me proces rregullatorë për vitin 2009 e ka përbush vetëm atë të prodhimit të ujit, duke e tejkaluar objektivin e caktuar për 26,43%, ndërsa tre treguesit tjerë i ka negativë, kështu që e dhëna e ujit të prodhuar devalvohet thajse plotësisht me mos përbushjen e të dhënave tjera dhe prodhimi i ujit si i tillë bëhet edhe ai i pa përfillshim, pasi që;

1. Sasia e ujit të humbur është më e lartë se ajo e përcaktuar si cak për vitin 2009 për 95,70%,
2. Sasia e ujit të faturuar është më e ulët se sasia e përcaktuar si cak për vitin 2009 për 12,00%, dhe
3. Sasia e ujërave të zeza të grumbulluara është më e ulët se sa sasia e aprovuar me procesin rregullatorë për vitin 2009 po ashtu për 12,00%

Edhe te kjo kompani do analizojmë të dhënat e vitit 2008 me atë të përmbyllur të vitit 2009, për çka duhet theksuar se;

- a) sasia e ujit të prodhuar te kjo kompani është më e lartë gjatë vitit 2009 për 21,39% në krahasim me vitin e shikuar 2008, dhe
- b) po ashtu ka ulje të sasisë së ujërave të zeza të grumbulluara për të njëjtën periudhë për 9,58%.

Ndërsa kur krahasohen dy treguesi tjerë kemi këto të dhëna;

- a) humbja e ujit është më e lartë gjatë vitit 2009 nga ajo e vitit 2008 për 51,84%, dhe
- b) faturimi po ashtu është më ulët gjatë vitit të shikuar 2009 se ai i vitit 2008 për 2,70%,

Nëse komentohen të dhënat e këtij grupimi të koj kompanie për vitin 2009, shohim se kompania përveç që ka tejkaluar shumën e sasisë së ujit të prodhuar gjatë vitit 2009 për 26,43%, ka dështuar ti përmbush tri caqet tjera të përcaktuara për sasinë e faturimit të ujit, ujërave të zeza dhe zvogëlim të sasisë së ujërave të humbura e cila sasi si e humbur ishte dyfishuar në krahasim me të dhënë e tillë të lejuar me procesin rregullatorë të vitit 2009. Ngritja e sasisë së ujit të prodhuar devalvohet me tre treguesit tjerë dhe të dhënat e tilla të dale nuk janë tregues shpresëdhënës për vitin 2010 e 2011.

Pas, mos realizimit të objektivave të përcaktuara me procesin rregullatorë për vitin 2009, kompania angazhimi i saj duhet tani e tutje të drejtohet në përmbushjen e caqeve të përcaktuara me procesin rregullatorë të vitit 2010 e 2011, të dhënat e të cilave do të monitorohen gjatë këtij viti dhe vitit pasues.

- **KRU "BIFURKACIONI" Sh. A. Ferizaj**

Kjo kompani nga katër treguesit operativë të theksuar te Tabela. Nr. 1, të shikuar nga aspekti i përmbushjes së objektivave të përcaktuara me proces rregullatorë për vitin 2009 i ka të pa përmbushur që të gjithë, pasi që;

1. Sasia e ujit të prodhuar gjatë vitit 2009 është më ulët se ajo e përcaktuar me procesin rregullatorë të vitit 2009 për 14,36%
2. Sasia e ujit të humbur është më e lartë se ajo e përcaktuar si cak me procesin rregullatorë për të njëjtën periudhë kohore për 7,92%,
3. Sasia e ujit të faturuar është më e ulët se sasia e aprovuar me procesin rregullatorë për vitin 2009 për 32,88%, dhe
4. Sasia e ujërave të zeza të grumbulluara është më e ulët se sa sasia e aprovuar me procesin rregullatorë për vitin 2009 po ashtu për 32,88%.

Edhe për këtë kompani po bëjmë krahasimin e të dhënave të përmbyllura për vitet 2008 me ato të vitit 2009, për çka duhet theksuar se;

- a) sasia e ujit të prodhuar tek kjo kompani ka qenë më e lartë gjatë vitit 2009 për 31,38% në krahasim me vitin e shikuar 2008, dhe
- b) po ashtu kemi ngritje të sasisë së ujit të humbur gjatë vitit 2009 në krahasim me vitin 2008 për 58.19%

Ndërsa kur të krahasohen dy treguesit të tjerë kemi këto të dhëna;

- a) faturimi i ujit është më i lartë gjatë vitit të shikuar 2009 se ai i vitit 2008 për vetëm 7,10%, dhe
- b) faturimi i ujërave të zeza të grumbulluara gjatë vitit 2009 nga ato të vitit 2008 është më i ulët për 21,92%

Nëse komentohen të dhënat e përgjithshme të shikuara të kësaj kompanie për vitin 2009, shohim se kompania asnjë tregues nuk e ka pozitivë në krahasim me përmbushjen e caqeve të përcaktuara me proces rregullatorë të vitit 2009. Në përgjithësi të dhënat e tilla nuk janë tregues shpresëdhënës për vitin 2010 dhe 2011.

Angazhimi i saj duhet tani e tutje duhet të drejtohet në përbushjen e caqeve të përcaktuara me procesin rregullatorë të vitit 2010 e 2011, të dhënat e të cilave do të monitorohen gjatë këtij vit dhe vitit pasues.

- **KRU "HIDROMORAVA" Sh. A. Gjilan**

Kjo kompani nga të katër treguesit operativë të theksuar te Tabela. Nr. 1, të shikuar nga aspekti i përbushjes së caqeve të përcaktuara me proces rregullatorë për vitin 2009, një e ka të përbushur dhe tre të tjerë jo, pasi që;

1. Sasia e ujit të prodhuar gjatë vitit 2009 është më e ulët se ajo e përcaktuar me procesin rregullatorë të vitit 2009 për 21,79%
2. Sasia e ujit të humbur është më e ulët se sasia e tillë e përcaktuar me proces rregullatorë për vitin 2009 për 28,54% i cili merret si tregues pozitivë në këtë rast,
3. Sasia e ujit të faturuar është më e ulët se sasia e aprovuar si cak rregullatorë për vitin 2009 për 10,59%, dhe
4. Sasia e ujërave të zeza të grumbulluara është më e ulët se sa sasia e aprovuar me procesin rregullatorë për vitin 2009 po ashtu për 10,59%

Edhe pse nuk janë çështje të analizave tona vitet krahasuese 2008 me atë të përmbyllur të vitit 2009, duhet theksuar se;

- a) sasia e ujit të prodhuar nga kjo kompani ka qenë më e lart gjatë vitit 2009 për 18,63% në krahasim me vitin e shikuar 2008,
- b) kjo kompani po ashtu ka pas ngritje të sasisë së ujit të humbur gjatë vitit 2009 për 38,23% në krahasim me vitin paraprak të shikuar

Ndërsa kur të krahasohen dy treguesit të tjerë kemi këto të dhëna;

- a) faturimi i ujit është më i ulët gjatë vitit të shikuar 2009 se ai i vitit 2008 për 0.14%, dhe
- b) sasia e faturimi të ujërave të zeza të grumbulluara gjatë vitit 2009 është më e ulët se sasia e tillë e faturuar gjatë vitit 2008 për 20.93%

Nëse komentohen të dhënat e përgjithshme të shikuara të kësaj kompanie për vitin 2009, shohim se kompania vetëm treguesin e humbjeve të ujit e ka mjaft inkurajues dhe shpresëdhënës, ndërsa që të tre të tjerët i ka përmbyll me të dhëna negative dhe atë dukshëm nën të dhënat e planifikuara me procesin rregullatorë të vitit 2009.


Në përgjithësi të dhënat e tilla nuk janë tregues shpresëdhënës për vitin 2010 e 2011.

Pasi që tre treguesit e kësaj kompanie nuk janë përbushur dhe me vetëm një tregues pozitivë të dhënat e këtij grupimi nuk janë shumë shpresëdhënës për vitet vijuese. Angazhimi i saj duhet tani e tutje të drejtohet në përbushjen e caqeve të përcaktuara me procesin rregullatorë të vitit 2010 dhe 2011, të dhënat e të cilave do të monitorohen gjatë këtij viti dhe vitit pasues.


4.1.2. PARAQITJA GRAFIKE E TË DHËNAVE SASIORE PËR UJIN E PRODHUAR DHE TË FATURUAR TE KRU-TË

Në vijim të këtij raporti pa ofruar ndonjë koment tonin po i paraqesim në mënyrë grafike të dhënat e veçanta të çdo kompanie për prodhim të ujit, humbjen e tij, shumën e faturimit si të veçantë për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, për të gjitha KRU-të me qëllim që të shihen lëvizjet e tyre.


Diagrami Nr. 1. Prodhimi i ujit në m3




Diagrami Nr. 2. Uji i humbur në m3



Diagrami Nr. 2. Uji i faturuar në m3



Diagrami Nr. 3. Faturimi i ujërave të zeza në m3



4.1.3. TË DHËNAT SEKTORIALE PËR PRODHIM, HUMBJE DHE FATURIM TË SASISË SË UJIT

Edhe treguesit e shikuar sektorial për prodhim të ujit, humbje të tiji, faturim të ujit dhe faturim të ujërave të zeza të grumbulluara kanë fatin e njëjtë sikurse e kemi përshkruar te shtatë kompanitë e shikuara më parë.

Tani po i shikojmë në grup katër të dhënat e theksuara ma lartë dhe treguesit e dalë sektorial të planifikuar për tu përmbushur si objektive të përcaktuara me procesin rregullatorë për vitet 2009.

Komentet tona do të përmbliidhen radhazi sikurse i kemi pasqyruar në pasqyrën tonë tabelore, dhe atë;

1. Sasia e ujit të prodhuar e përcaktuar si qellim për tu përmbush gjatë vitit 2009 ishte më e ulët në fund të vitit 2009 për 2,02%,
2. Sasia e ujërave të humbura sektoriale e përcaktuar si cak për të njëjtën periudhë ishte më e lartë për 8,91%, që merret si indikatorë negativë,
3. Sasia e ujit të faturuar ishte më e ulët se caku i përcaktuar me procesin rregullatorë për vitin 2009 për 14,11%, dhe
4. Po ashtu edhe sasia e ujërave të zeza të grumbulluara gjatë vitit 2009 ishte më e ulët se caku i përcaktuar me procesin rregullatorë për vitin 2009 për 18,82%

Nëse të dhënat e vitit 2009 i krahasojmë me vitin 2008 do të shohim se kemi këta tregues të përmbyllur brenda dy periudhave krahasuese, dhe atë;


1. Sasia e ujit të prodhuar gjatë vitit 2009 ishte më e lartë se ajo e prodhuar gjatë vitit 2008 për 4,52%,
2. Sasia e ujërave të humbura sektoriale për të njëjtën periudhë ishte po ashtu më e lartë për 9,59%, që paraqet indikator negativ
3. Sasia e ujit të faturuar gjatë vitit 2009 është më e ulët se sasia e ujit të faturuar gjatë vitit 2008 për 1,84%, dhe
4. Sasia e ujërave të zeza të grumbulluara gjatë vitit 2009 është më e ulët se sasia e tillë e ujit të grumbulluar gjatë vitit 2008 për 10,22 %

Në vazhdim do ti pasqyrojmë disa të dhëna kryesore sektoriale duke krahasuar vitin 2009 me atë të vitit 2008, sikurse janë humbja e ujit, faturimi i ujit dhe ujërave të zeza;

1. Uji i humbur gjatë vitit 2009 është ngrit në 58,36%, nga 55,66% sa ka qenë gjatë vitit 2008,
2. Faturimi sasior i ujit gjatë vitit 2009 ka rënë në 41,64%, nga 44,34% sa ka qenë gjatë vitit 2008,
3. Faturimi i ujërave të zeza gjatë vitit 2009 ka rënë në 28,05%, nga 32,66% sa ka qenë gjatë vitit 2008.

Në përgjithësi që të gjithë treguesit nuk janë të mirë dhe u mbetet kompanive në mënyrë individuale me iu qasë çështjeve të tilla, për ta përmirësuar performancën e tyre gjatë vitit 2010 dhe 2011.

Diagrami Nr. 4. Paraqitja grafike e të dhënave sektoriale për ujin prodhuar dhe faturuar në m3



Është evidente se që të gjitha kompanitë kanë dështuar në realizimin e objektivave të përcaktuara me procesin e theksuar rregullatorë.

Edhe ato tri kompani, si; “Prishtina”, “Mitrovica” dhe “Hidroregjioni-Jugor” që kanë përbush cakun e përcaktuar të prodhimit të ujit, që të gjithë treguesit tjerë janë nën objektivat e përcaktuara, kështu që sasia e ujit të prodhuar është më negative, se mos me e pas prodhuar të njëjtën sasi shtesë fare.

Kjo ndërlidhet me faktin se humbjet e ujit janë më të mëdha, faturimi ujit dhe ujërave të zeza është më i ulët etj.

Dështime të theksuar ka tek faturimi i ujit të prodhuar për këtë periudhë kohore të shikuar, pastaj, te sasia e grumbullimit të ujërave të zeza kur shikohet kjo periudhë kohore. Kur i shikojmë të dhënat e tilla të vitit 2008 dhe i krahasojmë të njëjtat me vitin e përmbyllur tani 2009, do të shohim se parametrat e prodhimit të ujit tek disa kompani janë përbush e te disa të tjera jo, edhe ta faturimi kemi të njëjtin gjendje, pasi që te disa kompani kemi faturimin sasior më të ulët se sa faturimet e tilla të vitit 2008 e te disa kemi ngritje. Sikurse është rasti edhe te grumbullimi sasior i ujërave të zeza.

Vlen të theksohet se sasia e faturimit të ujit gjatë kësaj periudhe kohore është më e ulët për 13,74% dhe ajo e grumbullimit të ujërave të zeza për 10,22%.

**TË DHËNAT DHE GJETJET PËR SHPENZIMET OPERATIVE TË:
STAFIT, ENERGJISË ELEKTRIKE, SHPENZIMEVE TJERA
OPERATIVE, SHUMËS SË SHPENZIMEVE OPERATIVE
DHE NUMRIT TË KONSUMATORËVE**

4.2. ANALIZA E SHPENZIMEVE OPERATIVE

Edhe për analizën e grupimit të këtyre të dhënave do të veprohet sikurse që është vepruar me të dhënat operative të prodhimit dhe faturimit të ujit. Do të analizohen të dhënat e dala nga krahasimi i përbushjes së caqeve të përcaktuara me procesin rregullatorë 2009-2011 për vitin 2009 dhe të dhënave të përmbyllura të vitit 2008 me ato të vitit 2009 edhe pse për të njëjtat nuk jemi shumë të fokusuar.

Të dhënat e pasqyruara në këtë tabelë janë nxjerr nga Raportet Përmbledhëse të përcaktimeve të tarifave të vitit 2009 për çdo kompani veç e veç dhe ato të realizuara nga kompanitë të cilat janë verifikuar me procesin e auditimit të DP dhe nga të dhënat e Pasqyrës së T'ardhurave të vitit të përmbyllur të çdo kompanie.

Tabela . Nr. 2. Analiza e shpenzimeve operative për vitin 2009

mërtimi i KRU-v	Të dhënat e shpenzimeve financiare	Nivëzia	Kategoritë e shpenzimeve dhe numri i konsumatorëve					
			Ujë			Kanalizim		
			Realizuara 2008	Aprovuara nga ZRRUM 2009	Realizuara 2009	Realizuara 2008	Aprovuara nga ZRRUM 2009	Realizuara 2009
"Prishtina" Sh.a Prishtine	Stafi (personeli)	€	2,737,785	2,689,600	2,578,245		343,200	140,200
	Energjia elektrike	€	1,486,878	1,474,100	1,833,947		35,100	7,706
	Shpenzimet tjera operative	€	1,550,408	2,100,400	1,740,152		94,700	13,840
	Σ e shpenzimeve operative	€	5,775,071	6,264,100	6,152,344	-	473,000	161,746
	Numri i Konsumatoreve	Nr.		70,196	86,491		59,355	73,517
"Mitrovica" Sh.a Mitrovice	Stafi (personeli)	€	892,863	843,000	825,189		96,000	51,372
	Energjia elektrike	€	278,801	239,000	316,866		37,000	
	Shpenzimet tjera operative	€	658,313	568,000	665,460		110,000	21,684
	Σ e shpenzimeve operative	€	1,829,977	1,650,000	1,807,515	-	243,000	73,056
	Numri i Konsumatoreve	Nr.		19,864	21,314		15,920	17,051
"Hidrodrini" Sh.a Peje	Stafi (personeli)	€	730,221	587,700	790,416		89,000	41,601
	Energjia elektrike	€	214,621	151,000	311,342			-
	Shpenzimet tjera operative	€	324,065	521,600	328,937		46,000	15,768
	Σ e shpenzimeve operative	€	1,268,907	1,260,300	1,430,695	-	135,000	57,369
	Numri i Konsumatoreve	Nr.		29,960	30,896		12,197	12,667
"Hidrosistemi Radoniqi" Sh.a - Gjakove	Stafi (personeli)	€	1,155,354	1,144,800	1,198,955		92,000	85,357
	Energjia elektrike	€	133,354	136,000	138,278			19
	Shpenzimet tjera operative	€	429,556	433,500	450,905		13,500	10,129
	Σ e shpenzimeve operative	€	1,718,264	1,714,300	1,788,138	-	105,500	95,505
	Numri i Konsumatoreve	Nr.		25,872	27,230		14,295	14,976
"Hidroregjioni Jugor" Sh.a - Prizren	Stafi (personeli)	€	909,717	835,000	856,103		40,300	105,808
	Energjia elektrike	€	412,981	382,100	465,098		26,100	62,076
	Shpenzimet tjera operative	€	524,311	380,100	567,952		51,400	19,203
	Σ e shpenzimeve operative	€	1,847,009	1,597,200	1,889,153	-	117,800	187,087
	Numri i Konsumatoreve	Nr.		27,605	31,230		25,260	28,419
"Bifurkacioni" Sh.a Ferizaj	Stafi (personeli)	€	380,131	222,700	345,431		120,000	38,913
	Energjia elektrike	€	31,821	16,600	32,289		400	-
	Shpenzimet tjera operative	€	289,240	165,700	147,618		132,600	5,555
	Σ e shpenzimeve operative	€	701,192	405,000	525,338	-	253,000	44,468
	Numri i Konsumatoreve	Nr.		16,277	13,694		13,872	11,640
"Hidromorava" Sh.a Gjilan	Stafi (personeli)	€	576,028	438,986	328,674		109,600	25,556
	Energjia elektrike	€	105,841	260,947	109,685		13,800	293
	Shpenzimet tjera operative	€	377,250	259,622	593,359		117,200	11,207
	Σ e shpenzimeve operative	€	1,059,119	959,555	1,031,718	-	240,600	37,056
	Numri i Konsumatoreve	Nr.		14,901	16,676		13,487	15,008
Të dhënat e përgjithshme të sektorit	Stafi (personeli)	€	7,382,099	6,761,786	6,923,013	-	890,100	488,807
	Energjia elektrike	€	2,664,297	2,659,747	3,207,505	-	112,400	70,094
	Shpenzimet tjera operative	€	4,153,143	4,428,922	4,494,383	-	565,400	97,386
	Σ e shpenzimeve operative	€	14,199,539	13,850,455	14,624,901	-	1,567,900	656,287
	Numri i Konsumatoreve	Nr.	-	204,675	227,531	-	154,386	173,278

Në vijim po i analizojmë shkurtimisht të dhënat kryesore të katër grupimeve të shpenzimeve, si; shpenzimet e pagave, shpenzimet e energjisë elektrike, shpenzimeve tjera operative dhe shumës së shpenzimeve të përgjithshme, që të gjitha për vitin 2009.

Para së të fillojmë analizën e kësaj pasqyre duhet theksuar se, për arsye të mos shpalosjes së duhur të disa zërave me vlerë më të vogël të shpenzimeve, fondit të pagave në disa raste i janë shtuar shuma të caktuara të cilat mund ta kenë ngritur vlerën e fondit të pagave të aprovuara, për arsye se të njëjtat nuk kanë qenë qartë të specifikuar gjatë procesit të përcaktimit të tarifave me procesin e udhëhequr rregullator 2009-2011. Kjo mund të këtë ndikuar edhe te disa korrigjime të vogla tek zëri i shpenzimeve tjera operative.

4.2.1 SHPENZIMET OPERATIVE SIPAS KRU-ve

- **KRU "PRISHTINA" Sh. A. Prishtinë**

Nga shikimi i këtij grupimi të dhënave të fondit të pagave të planifikuara nga kompania dhe të aprovuara nga DFTRR/ZRRUM për vitin 2009, për shërbimet e ujit dhe kanalizimit, mund të theksohet se kjo kompani fondin e tillë të pagave e ka pas më të ulët për 10,37%, ato të shpenzimeve të energjisë elektrike për të njëjtën periudhë kohore I ka tejkalar për 22,03%, ndërsa shpenzimet tjera operative të shikuara po ashtu i ka më të ulëta për 20.10%.

Gjithsejtë shuma e shpenzimeve operative për këtë periudhë kohore të vitit 2009 sipas të njëjtës metodologji ishte më e ulët për 6,28% nga shuma e tillë e lejuar për vitin e shikuar.

Ndërsa kur totalin e këtyre shpenzimeve të vitit 2009 e krahasojmë me të dhënat e njëjta të vitit të kaluar, të njëjtat janë ngritur gjatë vitit 2009 për 9,33%.

Mos shfrytëzimi i të drejtës për shpenzim të fondit të pagave të aprovura nga DFTRR/ZRRUM është një veprim i drejtë dhe racional i kompanisë. Ndërsa ngritja e shumës së shpenzimeve të energjisë elektrike mbi shumën e aprovuar të këtij zëri duket të ketë qenë si arsye e vlerësimeve jo to mira.

Për sa i përket shpenzimeve tjera operative kompania nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e vet të përcaktuar për këtë qellim me çka mund të sjell veten në uljen e nivelit të shërbimit ndaj konsumatorëve dhe me këtë edhe uljen e vlerës së aseteve të veta.

Si vlerësim i përgjithshëm del se kompania i ka racionalizuar shpenzimet e veta duke mos e shpenzuar gjithë shumën e aprovuar dhe me këtë ky veprim i saj mund të jetë dy kahesh. Në njërin kemi uljen e kostos së prodhimit dhe kjo gjë është e mirë derisa të mos cenohet niveli i shërbimit. Por, nëse është e kundërta kjo gjë del të jetë e kundërta e saj.

- **KRU "MITROVICA" Sh. A. Mitrovicë**

Kjo kompani shumën e fondit të pagave të planifikuara dhe të aprovuara nga DFTRR/ZRRUM për vitin 2009, e ka pas më të ulët për 6,65%, ato të shpenzimeve të energjisë elektrike për të njëjtën periudhë kohore e ka tejkalar për 14,81%, ndërsa shpenzimet tjera operative të shikuara për të njëjtën periudhë i ka tejkalar për vetëm 1,35%.

Gjithsejtë shumen e shpenzimeve operative për këtë periudhë kohore të vitit 2009 sipas të njëjtës metodologji, kjo kompani e ka më të ulët për vetëm 0,66% nga shuma e tillë e lejuar për vitin e shikuar.

Ndërsa kur totalin e këtyre shpenzimeve të vitit 2009 e krahasojmë me të dhënat e njëjta të vitit të kaluar, të njëjtat janë ngritur gjatë vitit 2009 për 4.38%.

Mos shfrytëzimi i të drejtës për shpenzim të fondit të pagave të aprovura nga DFTRR/ZRRUM, është vlerësuar si një veprim i drejtë dhe racional i kësaj kompanie. Ndërsa ngritja e shumës së shpenzimeve të energjisë elektrike mbi shumën e aprovuar të këtij zëri është një veprim jo i mirë për të cilin kompania është dashur të ketë më shumë kujdes.

Kompania gjithë shumën e shpenzimeve të aprovuara për afarizmin e vet vjetor 2009 e ka shfrytëzuar, me çka shpresojmë se ka përbushur misionin e vet ndaj konsumatorëve për këtë grupim të dhënave.

- **KRU "HIDRODRINI" Sh. A. Pejë**

Edhe KRU "Hidrodrini" Sh. A. Pejë, shumën e fondit të pagave të planifikuara nga kompania dhe të aprovuara nga DFTRR/ZRRUM për vitin 2009, e ka tejkaluar për 22,95%, ato të shpenzimeve të energjisë elektrike për të njëjtën periudhë kohore e ka tejkaluar për 106,19%, ndërsa shpenzimet tjera operative të shikuara për të njëjtën periudhë i ka pas më të ulëta për 39,27%.

Shuma e përgjithshme e shpenzimeve tjera operative për periudhë kohore të vitit 2009 sipas të njëjtës metodologji është më e lartë për 6,65% nga shuma e tillë e lejuar për vitin e shikuar, ndërsa kur totalin e këtyre shpenzimeve të vitit 2009 e krahasojmë me të dhënat e njëjta të vitit të kaluar, të njëjtat janë ngritur gjatë vitit 2009 për 17,27%.

Rasti i kësaj kompanie është më specifik nga dy kompanitë e theksuara më lartë pasi që e njëjta ka tejkaluar në mënyrë të ndjeshme shumën e shpenzimeve të pagave dhe ka dyfishuar shpenzimet e energjisë elektrike, ndërsa ka ulë shpenzimet tjera operative për më tepër se një të tretën.

Në vazhden e asaj që theksuam më lartë del se kompania ka tejkaluar edhe shumën e përgjithshme të shpenzimeve të aprovuara me procesin rregullatorë të vitit 2009 për 6.65%, gjë që është shumë.

Në anën tjetër mos realizimi i shumës së përgjithshme të shpenzimeve tjera operative të planifikuara mund të ketë ndikuar në uljen e nivelit të shërbimeve që kjo kompani u ofron konsumatorëve të vet dhe eventualisht uljen e vlerës së aseteve të saja, pasi që një pjesë e shumës në fjalë ka të bëjë me riparime dhe mirëmbajtje të aseteve të veta.

Si vlerësim i përgjithshëm del se kompania ka tejkaluar zërat kryesorë të shpenzimeve operative dhe në këtë mënyrë edhe shumën e përgjithshme të shpenzimeve, dhe e njëjta gjatë këtij viti duhet të reduktohet dhe silllet në nivelin e të dhënave të aprovuara me procesin rregullatorë për vitin 2010 dhe 2011.

- **KRU "RADONIQI" Sh. A. Gjakovë**

Kjo kompani shumën e fondit të pagave të planifikuara dhe të aprovuara nga DFTRR/ZRRUM për vitin 2009, për shërbimet e ujit dhe kanalizimit e ka tejkaluar për 3,84%, ato të shpenzimeve të energjisë elektrike për të njëjtën periudhë kohore, po ashtu e ka tejkaluar për 1,69%, ndërsa edhe shuma e shpenzimeve tjera operative të shikuara për të njëjtën periudhë është tejkaluar për 3,14%.

Gjithsejtë shuma e shpenzimeve operative për vitin 2009 sipas të njëjtës metodologji është tejkaluar për 3,51% nga shuma e tillë e planifikuar gjatë vitit 2009. Ndërsa, kur totalin e këtyre shpenzimeve të vitit 2009 e krahasojmë me të dhënat e njëjta të vitit të kaluar, të njëjtat janë ngritur gjatë vitit 2009 për 9,62%.

Nga të dhënat e theksuara del se kompania i ka pas nën kontroll të gjitha grupimet shpenzimeve dhe mund të thuhet me pak përjashtime afarizmin e vet e ka realizuar në mënyrë racionale, për sa u përket të dhënave të shikuara.

Si vlerësim i përgjithshëm del se kompania ka përformuar relativisht mirë me shpenzime gjatë vitit 2009.

- **KRU "HIDROREGJIONI - JUGOR" Sh. A. Prizren**

KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh. A. Prizren, që të gjithë treguesit e dalë sipas kësaj pasqyre i ka tejkaluar nga shumatat e planifikuara dhe aprovuara nga DFTRR/ZRRUM me procesin rregullatorë të vitit 2009 dhe atë relativisht në shumata të larta.

Fondin e pagave për vitin 2009 për të dy shërbimet kompania e ka tejkaluar për 9,89%, ato të shpenzimeve të energjisë elektrike e ka tejkaluar për të njëjtën periudhë kohore për afër një të tretën, shprehur në % kjo ngjitje është për 29,15% më e lartë edhe shpenzimet tjera operative i ka tejkaluar për mase një të tretën, ose për 36,07%.

Si rezultat i të dhënave të theksuara më lartë kemi edhe tejkalinimin e shumës së shpenzimeve të përgjithshme operative për të njëjtën periudhë kohore të vitit 2009 sipas të njëjtës metodologji dhe ete për 21,06%.

Ndërsa kur totalin e këtyre shpenzimeve të vitit 2009 e krahasojmë me të dhënat e njëjta të vitit të kaluar, të njëjtat janë ngritur gjatë vitit 2009 për 12,41%.

Kompania duhet seriozisht ti shikoj shkaktarët e një ngritje aq të lartë të shpenzimeve të veta operative dhe gjithë zërave, sikurse që duhet tu kushtohet kujdes dhe analizuar të njëjtat, për ti sjellë në suaza të rrethanave normale të shumave të aprovuara s`bashku me procesin rregullatorë të vitit 2009.

Tejkalimi i shumës së shpenzimeve të planifikuara të energjisë elektrike dhe të grupimit tjetër të shpenzimeve tjera operative është një sinjal jo i mirë dhe duhet të shqetësojë menaxhmentin sikurse që është rasti edhe me tejkalimet e ndodhura te fondi i pagave.

Si vlerësim i përgjithshëm del se kompania nuk i ka kushtuar kujdes të duhur racionalizimit të shpenzimeve të veta dhe një praktikë e tillë duhet të ndryshohet gjithsesi gjatë këtij viti dhe vitit pasues.

- **KRU "BIFURKACIONI" Sh. A. Ferizaj**

Nga krahasimi i të dhënave të përcaktuara me procesin rregullatorë të vitit 2009 për shpenzimet e planifikuara të kësaj kompanie del se, dy tregues të shpenzimeve të shikuara e njëjta i ka tejkaluar dhe në dy tregues të tjerë janë nën nivelin e përcaktuar me procesin rregullatorë të vitit 2009.

Fondin e pagave për vitin 2009 për të dy shërbimet "Bifurkacioni" e ka tejkaluar për 12,15%, ato të shpenzimeve të energjisë elektrike për të njëjtën periudhë kohore e njëjta e ka tejkaluar për 89,93%.

Ndërsa, shuma e shpenzimeve tjera operative të shikuara për të njëjtën periudhë e njëjta e ka përmyll nën shumën e lejuar për 48,65% dhe atë të shumës së përgjithshme të shpenzimeve operative e ka nën shumën e lejuar për 13,40%.

Ndërsa, kur totalin e këtyre shpenzimeve të vitit 2009 e krahasojmë me të dhënat e njëjta të vitit të kaluar shohim se shuma e shpenzimeve të tilla të ndodhura gjatë vitit 2009 janë më të ulëta për 18,74% në krahasim me shumën e shpenzimeve të tilla të përmyllura për vitin 2008.

Kompania duhet seriozisht ti shikoj shkaktarët e një ngritje aq të lartë të zërave të shpenzimeve të pagave dhe të energjisë elektrike, sikurse që duhet shikuar edhe mos shpenzimin e shumave të caktuar për shpenzimet tjera operative dhe atë të shumës së përgjithshme operative për të njëjtën periudhë kohore.

Edhe pse nga kjo kompani është shkëputë Njësia e Kaçanikut e njëjta që të gjitha grupimet e këtij shpenzimi do të duhet të kishte ma të ulëta e jo si ato të dala nga të dhënat e marra dhe të krahasuar, pastaj me objektivat e përcaktuara.

Si vlerësim i përgjithshëm del se kompania duhet të fokusohet në shumën e shpenzimeve të tejkaluara dhe tek shumën e shpenzimeve tjera operative, pasi që e njëjta me mos realizim të punëve të këtyre zërave mund ta zvogëlojë vlerën e aseteve të veta.

- **KRU "HIDROMORAVA" Sh. A. Gjilan**

Nga krahasimi i katër treguesve të dalë të kësaj tabele për KRU "Hidromorava" Sh. A. Gjilan, shohim se tre nga ta i ka me vlera negative dhe një tjetër e ka vlera me vlerë pozitive, kur krahasohen me objektiva e përcaktuara me procesin rregullatorë të vitit 2009.

Fondi i përbashkët i pagave për vitin 2009 për shërbimin e ujësjellësit dhe atë të kanalizimit të kjo kompania ishte më të ulët se shuma e lejuar me procesin rregullator për vitin 2009 për 35,43%, ato të shpenzimeve të energjisë elektrike për të njëjtën periudhë kohore janë pa ashtu më të ulëta për 59,97% për të cilën zë kompania ka insistuar me e ngrit dukshëm mbi shumën e aprovuar, ndërsa shpenzimet tjera operative të shikuara për të njëjtën periudhë i ka tejkaluar për 60,23%.

Si rezultat i të dhënave të theksuara më lartë, kemi ulje të kostove të përgjithshme të shpenzimeve operative për të njëjtën periudhë kohore në krahasim me cakun e përcaktuar për 10.95%.

Kompania duhet seriozisht ti shikojë shkaktarët e caqeve të tilla të përcaktuara me procesin rregullator i cili mund të jetë;

- nga arsyeja e të dhënave të mbi vlerësuar për shpenzimet operative me lëshimin në punë të fabrikës së re të përpunimit të ujit, ose
- marrjes së ndonjë donacioni për mbulimin e ndonjë zëri të shpenzimeve operative për të cilin ne nuk jemi të informuar, ose
- mund të jetë si arsye eventuale edhe ulja e nivelit të shërbimit për konsumatorët e shërbyer.

Kur krahasohen të dhënat e përgjithshme të shpenzimeve të vitit 2009 me të dhënat e njëjta të vitit të kaluar shohim se shuma e shpenzimeve të tilla të ndodhura gjatë vitit 2009 është më e lartë se ajo e vitit 2008 për vetëm 0,91%.


Si rezultat i kësaj, DFTRR do ti monitorojë ngushtë këto të dhëna edhe gjatë këtij vitit afarist dhe me kohë do të paralajmërojë palët e interesit për gjetjet e veta për këtë grupim dhe të dhënat tjera.

4.2.2. PARAQITJA GRAFIKE E TË DHËNAVE PËR SHPENZIME OPERATIVE PËR KRU-TË


Në vijim të këtij raporti pa ofruar ndonjë koment tonin po i paraqesim në mënyrë grafike të dhënat sektoriale të shpenzimeve operative të përcaktuara si cak për vitin 2009 nga procesi taritorë i shërbimeve të ujit për vitet 2009 -2011, nga të cilat po theksojmë katër grupime kryesore, si; fondin e pagave, shpenzimet e energjisë elektrike, shumën e shpenzimeve tjera operative dhe shumën e përgjithshme të shpenzimeve operative për vitin 2009, të cilat shikohen me të dhënat e përmbyllura sektoriale të audituara të këtij grupimi gjatë vitit 2009.

Të dhënat grafike do të na tregojnë lëvizjet figurative të këtyre shpenzimeve gjatë vitit 2009 dhe një krahasim me shpenzimet e vitit 2008.

Diagrami Nr. 5. Shpenzimet operative për shërbimet e ujësjellësit



Diagrami Nr. 6. Shpenzimet operative për shërbimet e kanalizimit



4.2.3 SHPENZIMET OPERATIVE NË NIVEL TË SEKTORIT

Shpenzimet operative sektoriale të planifikuara si rezultat i çaqeve (objektivave) të përcaktuara me procesin rregullator të vitit 2009 pasqyrojnë të dhënat individuale të kompanive dhe të njëjtat do të përmbliken për pesë tregues.

Që të tri grupimet e shpenzimeve operative sektoriale janë nën parashikimet e përcaktuara me procesin rregullator të vitit 2009;


- Fondi i pagave për periudhën e shikuar të vitit 2009 është më i ulët për 3,14%,
- Shpenzimet e energjisë elektrike për të njëjtën periudhë kohore janë tejkaluar për 18,23%.
- Ndërsa shpenzimet tjera operative i ka më të ulëta për 8,06%.

Kur krahashojmë shpenzimet e përgjithshme të përcaktuara me procesin rregullator të vitit 2009 shohim se të njëjtat janë përmbushur në shumë të përgjithshme, duke u ngritë mbi objektivin e caktuar vetëm për 0,89%.

Nëse i krahasojmë shpenzimet e përgjithshme operative të vitit 2008 me ato të përmbyllura të vitit 2009 do të shohim se KRU-të kanë shpenzuar më shumë gjatë vitit 2009 për 7,62% se sa shpenzimet e tilla të ndodhura gjatë vitit 2008

Me përjashtime të caktuara kompanitë duhet të përqendrohen në balancimin e shpenzimeve të veta nga një grupim tek tjetri.

Tabela Nr. 2. Të dhënat grafike sektoriale për shpenzimeve operative për vitet 2008 dhe 2009



***TË DHËNAT DHE GJETJET NGA ANALIZA E BËRË PËR:
VLERËN MONETARE TË FATURIMIT
DHE INKASIMIT***

4.3. ANALIZA E FATURIMIT DHE INKASIMIT

Para se ti pasqyrojmë të dhënat e faturimit dhe të inkasimit të aprovuara me procesin rregullator 2009 – 2011, për vitin 2009 të përcaktuara si cak dhe vlerësojmë përbushjen e tyre, po i pasqyrojmë edhe të dhënat e tilla me të cilat kompletohet në një masë pasqyra e të dhënave kryesore operative dhe financiare të deklaruara nga KRU-të, për periudhën një vjeçare të cilat po ashtu janë audituar nga ekipi i ZRRUM-it gjatë tremujorit të dytë të këtij viti.

Edhe në këtë grupim të dhënave do të pasqyrohen caqet e përcaktuara me procesin rregullatorë për vitin 2009 dhe përbushjen e caqeve të përcaktuara, ose realizimi i caqeve të tilla gjatë vitit të shikuar kalendarik.

Prandaj, në vijim po i prezantojmë të dhënat vjetore për shumën e faturimit të çdo kompanie veç e veç dhe shkallën e inkasimit për të njëjtat, si dhe të dhënat sektoriale të përmbledhura për të dy shërbimet në një të dhënë (ujësjellës dhe kanalizim), për të cilat do epen edhe komentet për çdo njëri prej tyre, duke i përmbledhur pastaj edhe të dhënat për sektorin si tërësi, me konkluzione të nxjerra nga to.

Tabela Nr. 3 Të dhënat për shërbimet e faturimit të ujit dhe kanalizimit për vitin 2009

Emërtimi i KRU-ve	Të dhënat financiare	Mësi	Kategoritë e shpenzimeve dhe numri i konsumatorëve						Σ e tarifës fikse aprovuar nga ZRRUM 2009	Σ e faturimit nga tarifa fikse. Realizuar 2009	Σ e faturimit	
			Ujë			Kanalizim					Aprovuar nga ZRRUM	Realizuar nga KRU
			Realizuara	Aprovuara nga ZRRUM	Realizuara	Realizuara	Aprovuara nga	Realizuara			2009	2009
			2008	2009	2009	2008	2009	2009			2009	2009
"Prishtina" Sh.a Prishtine	Faturimi	€	9,147,772	9,423,910	8,074,313	914,627	1,064,992	724,504	1,006,900	1,152,446	11,495,802	9,951,263
	Inkasimi	€	6,029,848	7,580,673	6,457,949	605,339	767,002				8,347,675	6,457,949
"Mitrovica" Sh.a Mitrovicë	Faturimi	€	1,933,103	1,757,850	1,592,016	-	359,250	233,627	281,400	285,020	2,398,500	2,110,663
	Inkasimi	€	1,030,791	1,176,985	1,082,279	-	245,176				1,422,161	1,082,279
"Hidrodrini" Sh.a Pejë	Faturimi	€	2,275,047	1,670,985	1,694,298	-	293,694	202,199	477,144	426,126	2,441,823	2,322,623
	Inkasimi	€	1,511,953	1,506,039	1,403,846	-	197,061				1,703,101	1,403,846
"Hidrosistemi Radoniqi" Sh.a Gjakovë	Faturimi	€	2,461,809	2,775,114	1,926,592	-	341,208	213,814	411,444	401	3,527,766	2,140,807
	Inkasimi	€	1,756,631	2,450,098	1,748,934	-	291,826				2,741,924	1,748,934
"Hidroregjioni Jugor" Sh.a Prizren	Faturimi	€	2,382,250	2,110,900	1,960,729	-	347,400	286,169	429,400	431,881	2,887,700	2,678,779
	Inkasimi	€	1,517,229	1,387,300	1,614,192	-	209,508				1,596,808	1,614,192
"Bifurkacioni" Sh.a Ferizaj	Faturimi	€	900,592	832,128	648,486	-	306,468	103,882	252,816	176,013	1,391,412	928,381
	Inkasimi	€	512,882	722,123	562,307	-	202,037				924,160	562,307
"Hidromorava" Sh.a Gjilan	Faturimi	€	1,113,825	1,044,154	943,231	-	285,481	177,110	243,492	205,297	1,573,127	1,325,638
	Inkasimi	€	859,968	984,151	840,452	-	215,792				1,199,943	840,452
Shuma e përgjithshme	Faturimi	€	20,214,398	19,615,041	16,839,665	914,627	2,998,493	1,941,305	3,102,596	2,677,184	25,716,130	21,458,154
	Inkasimi	€	13,219,302	15,807,368	13,709,959	605,339	2,128,403	-		-	17,935,771	13,709,959

Edhe për analizën e grupimit të këtyre të dhënave do të veprojmë sikurse kemi vepruar te të dhënat operative dhe ato të shpenzimeve operative. Do të analizohen ato të dhëna që kanë dallime të theksuara nga të dhënat e përcaktuara si objektive për tu arrit me procesin tarifar të vitit 2009.

4.3.1. FATURIMI DHE INKASIMI SIPAS KRU-ve

- **KRU “PRISHTINA” Sh. A. Prishtinë**

Planifikimi i faturimit dhe inkasimit të kjo kompani gjatë vitit 2009 në krahasim me vitin 2008 ka qenë tejet ambiciozë dhe kjo mund të shihet nga fakti se gjatë periudhës një vjeçare të vitit 2009 është planifikuar ngritja e shumës së faturimit për 14.25% në krahasim me vitin 2008, sikurse që ishte planifikuar edhe ngritja e shumës së inkasimit për të njëjtën periudhë për 25.81%.

Synimet e tilla të kompanisë kanë qenë të pa përbushura duke u bazuar edhe në faktin se caqet e përcaktuara me procesin rregullatorë 2009 – 2011, për vitin 2009 të aprovuara s`bashku, kanë mbet pa u përbush për;

- shumën e faturimit për 13,44%, dhe
- për shumën e inkasimit për 22,64%

Duke parë gjendjen ekzistuese, kompania duhet të angazhohet me i përbush parametrat e përcaktuar me procesin rregullatorë, tani, të vitit 2010 dhe 2011 që të mos dështojë në përbushjen e caqeve të këtij viti dhe vitit pasues.

Këtë e theksojmë edhe për faktin se tarifat volumetrike të konsumatorëve shtëpiak gjatë vitit 2009 janë ngritur për 10,00% dhe për jo shtëpiakë për 21,54% në krahasim me tarifat e vitit 2008. E cila përforcon bindjen tonë se kompania ka dështuar ti përbush obligimet e marra në vitin e parë të vlefshmërisë së tarifave afatmesme 2009 – 2011.

Të dhënat e tilla janë dukshëm nën të dhënat e akorduara mes DFTRR/ZZRRUM e Kompanisë për vitin 2009.

Për mos me arrit në të njëjtën gjendje, kërkohet nga kompania të fokusohet fuqishëm tani në përbushjen e caqeve të përcaktuar për dy vitet tjera (2010 dhe 2011).

- **KRU “MITROVICA” Sh. A. Mitrovicë**

Edhe kjo kompani (sikurse të tjerat, me pak përjashtime) ka planifikuar ngritje të dukshme të shumës së faturimit dhe inkasimit gjatë vitit 2009 në krahasim me vitin 2008 dhe kjo mund të shihet nga fakti se gjatë periudhës një vjeçare të vitit 2009 e njëjta ka planifikuar me ngrit shumën e faturimit për 24.08%, sikurse që ka planifikuar edhe ngritjen e shumës së inkasimit për të njëjtën periudhë për 37,97%.

Synimet e tilla të kompanisë kanë qenë tejet ambicioze pasi që të njëjtat nuk janë përbush ashtu si janë planifikuar.

Kur krahasohen të dhënat e caqeve të përcaktuara me procesin rregullatorë 2009 – 2011 për vitin 2009, kompania ka dështuar në masë të madhe me i përbush të njëjtat, pasi që;

- shuma e faturimit në fund të vitit 2009 ishte për 12,00% më e ulët, se shuma e përcaktuar si cak gjatë të njëjtit vit, dhe
- shuma e inkasimit në fund të së njëjtës periudhë ishte më e ulët për 23,90%, në krahasim me shumën e përcaktuar si cak gjatë vitit 2009.

Duke parë gjendjen ekzistuese, kompania duhet të angazhohet me i përbush parametrat e përcaktuara me procesin rregullator, tani, të vitit 2010 dhe 2011 që të mos dështojë ti përbush edhe të dhënat e caqeve të përcaktuara të këtij viti dhe vitit pasues.

Këtë e theksojmë edhe për faktin se tarifat volumetrike të konsumatorëve shtëpiak gjatë vitit 2009 janë ngritur për 6,45% dhe për konsumatorët jo shtëpiak për 18,57% në krahasim me tarifat e vitit 2008.

Kjo e dhënë përforcon bindjen tonë se kompania ka dështuar dukshëm në përbushjen obligimeve të veta të marra me procesin e fundit tariforë, për vitin e shikuar.

Për mos me arrit në të njëjtën gjendje, kërkohet nga kompania të fokusohet fuqishëm në përbushjen e cqeve të përcaktuara me procesin rregullatorë, tani për vitet 2010 dhe 2011.

- **KRU "HIDRODRINI" Sh. A. Pejë**

Kjo kompani ka qenë më realiste në planifikimin e ngritjes së shumës së faturimit dhe inkasimit gjatë vitit 2009 në krahasim me vitin 2008. Kjo shihet nga fakti se gjatë periudhës një vjeçare të vitit 2009 e njëjta ka planifikuar të ngrit shumën e faturimit për vetëm 7,33% në krahasim me të dhënë e njëjtë të vitit 2008, sikurse që ka planifikuar edhe ngritjen e shumës së inkasimit për të njëjtën periudhë kohore për 12,64%.

Synimet e tilla të kompanisë kanë qenë më realiste edhe pse të dhënat e tilla për tu përbush për një vit biznesor janë vështirë të arritshme pa një angazhim shtesë dhe përkushtim të madh.

Kur krahasohen të dhënat e cqeve të përcaktuara me procesin rregullator 2009 – 2011 për vitin 2009, kompania ka dështuar ti përbush caqet e përcaktuara, pasi që;

- shuma e realizuar e faturimit në fund të vitit 2009 është për 4,88% më e ulët, dhe
- shuma e inkasimit në fund të së njëjtës periudhë është më e ulët për 17,57%

Edhe kjo kompani duhet të angazhohet shumë ma tepër për ti përbush parametrat e përcaktuara me procesin rregullatorë, tani, të vitit 2010 dhe 2011 që të mos dështojë në realizim të synimeve përcaktuara të këtyre dy viteve tarifore.

Ngritja e tarifave për këtë kompani ka qenë ma e përmbajtur duke u mbështetë në marrëveshjen reciproke që kemi pas, me që rast duhet theksuar se tarifat volumetrike të konsumatorët shtëpiakë gjatë vitit 2009 janë ngritë vetëm për 4,76% dhe për konsumatorët jo shtëpiakë vetëm për 4,35% në krahasim me tarifat e vitit 2008.

Edhe kjo kompani ka dështuar me i përbushë obligimet e veta të marra me procesin e fundit tarifor, sidomos ato të shumës së inkasimit për vitin e shikuar.

Për mos me arrit në të njëjtën gjendje sërish, kërkohet nga kompania të fokusohet fuqishëm me i përbush caqet e përcaktuara me procesin rregullatorë, tani për vitet 2010 dhe 2011.

- **KRU "RADONIQI" Sh. A. Gjakovë**

KRU "Radoniqi" Sh. a Gjakovë, kishte planifikuar një ngritje të dukshme të shumës së faturimit dhe inkasimit gjatë vitit 2009 në krahasim me vitin 2008. Synimet e tilla mund të shihen nga fakti se gjatë periudhës një vjeçare të vitit 2009 ishte planifikuar ngritja e shumës së faturimit për 43,30% në krahasim me vitin 2008, sikurse që ishte planifikuar edhe ngritjen e shumës së inkasimit për të njëjtën periudhë për 56,09%.

Synimet e tilla të kompanisë kanë qenë të pa realizueshme duke u bazuar në faktin se caqet e përcaktuara me procesin rregullatorë 2009 – 2011 për vitin 2009 të aprovuara s`bashku, kanë mbet pa u përbush te;

- shuma e faturimit për 39,32%, dhe
- te shuma e inkasimit për 36,22%

Duke parë gjendjen ekzistuese, kompania duhet të angazhohet ti përmbush objektivet e përcaktuara me procesin rregullatorë, tani, të vitit 2010 dhe 2011 që të mos dështojë për ti përmbush edhe caqet këtij viti dhe vitit pasues.

Këtë e theksojmë edhe për faktin se tarifat volumetrike të konsumatorëve shtëpiak gjatë vitit 2009 janë ngrit për 6,67% dhe për jo shtëpiakë për 13,33% në krahasim me tarifat e vitit 2008. Këto dy të dhëna e përforcojnë bindjen tonë se, kjo kompani ka dështuar ti përmbush obligimet e marra në vitin e parë të vlefshmërisë së tarifave afatmesme 2009 – 2011.

Për mos me arrit në të njëjtën gjendje sërish, kërkohet nga kompania të fokusohet fuqishëm tani në përmbushjen e ceqeve të përcaktuara me procesin rregullatorë për dy vitet tjera të vlefshmërisë së tarifave ekzistuese (2010 dhe 2011).

- **KUR "HIDROREGJIONI - JUGOR" Sh. A. Prizren**

Edhe kjo kompani kishte planifikuar një shumë dukshëm më të lartë të faturimit, ndërsa te inkasomi ka qenë ma pak ambicioze gjatë vitit 2009 në krahasim me vitin 2008. Ky konkludim mbështet në faktin se gjatë periudhës një vjeçare të vitit 2009 ishte planifikuar një ngritje e shumës së faturimit për 21,22% në krahasim me vitin 2008, ndërsa ajo e shumës së inkasimit ishte ma e përmbajtur pasi që shkalla e inkasimit ishte planifikuar të ngritët vetëm 5,25%.

Edhe kjo kompani ka dështuar të arrijë shumën e faturimit dhe inkasimit të përcaktuar si objektivë gjatë vlefshmërisë së tarifave të vitit 2009, pasi që e njëjta ka pas këto rezultate;

- shuma e faturimit ka mbet pa u realizuar 7,23%,
- ndërsa shuma e inkasimit e përcaktuar si cak për vitin 2009 është tejkaluar për 1,09%

Në instancë të fundit kur shikohen gjerat realisht dhe krahasohen të dhënat e dala për vitin 2009 me ato të vitit 2008, mund të thuhet se edhe kjo kompani ka dështuar të përmbush cakun e dalë pozitivë të shumës së inkasimit sipas procesit rregullatorë për vitin 2009. Pasi që për vitin 2009 kemi pas ngritje të theksuar të tarifave në krahasim me vitin 2008.

Këtë e theksojmë për faktin se tarifat volumetrike të konsumatorëve shtëpiak gjatë vitit 2009 te kjo kompani janë ngrit për 8,33% dhe për jo shtëpiak për 17,39% në krahasim me tarifat e vitit 2008. Këto të dhëna përforcojnë bindjen tonë për atë që u theksua më lartë.

Për mos me arrit në të njëjtën gjendje, kërkohet nga kompania të fokusohet fuqishëm tani në përmbushjen e ceqeve të përcaktuara për dy vitet tjera (2010 dhe 2011).

- **KRU "BIFURKACIONI" Sh. A. Ferizaj**

Edhe kjo kompani kishte planifikimi një shumë dukshëm ma të lartë të faturimit dhe inkasimit gjatë vitit 2009. Pritjet e tilla kanë qenë tejet ambicioz dhe në dukje të pa mundur për tu arrit, kur të dhënat e tilla tani i krahasojmë me vitin e përmbyllur 2008. Këtë e theksojmë për faktin se gjatë periudhës një vjeçare të vitit 2009 ishte planifikuar ngritja e shumës së faturimit për 54,50% në krahasim me vitin 2008, sikurse që ishte planifikuar edhe ngritja e shumës së inkasimit për të njëjtën periudhë për 80,19%.

Synimet e tilla të kompanisë kanë qenë të pa përbushura duke u bazuar edhe në faktin se caqet e përcaktuara me procesin rregullatorë 2009 – 2011 dhe në kuadër të kësaj edhe për vitin e shikuar 2009 të aprovuara s`bashku, pasi që caqet e tilla kanë mbet pa u përbush te;

- shuma e faturimit për 33,28%, dhe
- te shuma e inkasimit për 39,15%

Duke parë gjendjen ekzistuese, kompania duhet të angazhohet ti përbush parametrat e përcaktuar me procesin rregullatorë, tani, të vitit 2010 dhe 2011 që të mos dështojë edhe më tepër në përbushjen e caqeve të përcaktuara për këtë vit dhe për vitin pasues.

Këtë e theksojmë edhe për faktin se tarifat volumetrike të konsumatorëve shtëpiak gjatë vitit 2009 janë ngritur për 6,25% dhe për jo shtëpiakë për 5,71% në krahasim me tarifat e vitit 2008.

Këto të dhëna përforcojnë bindjen tonë se kompania plotësisht ka dështuar në përbushjen e obligimeve të marra gjatë vitit të parë të vlefshmërisë së tarifave afatmesme 2009 – 2011.

Për mos me arrit në të njëjtën gjendje, kërkohet nga kompania të fokusohet fuqishëm tani në përbushjen e caqeve të përcaktuara për dy vitet tjera (2010 dhe 2011).

- **KRU "HIDROMORAVA" Sh. A. Gjilan**

Edhe te kjo kompani gjatë vitit 2009 kemi pas pritje tejet ambicioze pasi që e njëjta kishte planifikuar ngritjen e lartë të shumës së faturimit dhe inkasimit në krahasim me vitin 2008. Synimet e saja tejet ambicioze shihen pasi që kompania kishte planifikuar një ngritje të madhe të shumës së faturimit dhe inkasimit gjatë vitit 2009 në krahasim me të dhënat e tilla të përmbyllura për vitin 2008.

Faturimi ishte planifikuar të ngritet për 41,24% në krahasim me vitin 2008, sikurse që ishte planifikuar edhe ngritja e shumës së inkasimit për të njëjtën periudhë për 39,53%.

Synimet e tilla të kompanisë kanë qenë të pa përbushura duke u bazuar edhe për faktin se caqet e përcaktuara me procesin rregullatorë 2009 – 2011 për vitin 2009 të aprovuara s`bashku, kanë mbet pa u përbush, te;

- shuma e faturimit për 15,73%, dhe
- te shuma e inkasimit për 29,96%

Duke parë gjendjen ekzistuese, kompania duhet të angazhohet ti përbush tani parametrat e përcaktuara me procesin rregullator të vitit 2010 dhe 2011 që të mos dështojë ti përbush edhe caqet këtij viti dhe vitit pasues.

Këtë e theksojmë edhe për faktin se tarifat volumetrike të konsumatorëve shtëpiakë gjatë vitit 2009 janë ngrit për 16,67% dhe për jo shtëpiakë për 27,27% në krahasim me tarifat e vitit 2008.

Kjo e dhënë përforcon bindjen tonë se kompania ka dështuar shumë në përbushjen e obligimeve të veta të marra gjatë vlefshmërisë së tarifave afatmesëm të vitit 2009.

Për mos me arrit në të njëjtën gjendje, kërkohet nga kompania të fokusohet fuqishëm tani në përbushjen e caqeve të përcaktuara për dy vitet tjera (2010 dhe 2011).


4.3.2. PARAQITJA GRAFIKE E TË DHËNAVE TË FATURIMIT DHE INKASIMIT TË KRU-TË

Në vijim të këtij raporti pa ofruar ndonjë koment tonin po i paraqesim në mënyrë grafike të dhënat e veçanta të faturimit dhe inkasimit të çdo kompanie, të përcaktuara si cak për vitin 2009 nga procesi tariforë i shërbimeve të ujit për vitet 2009 - 2011 dhe shkallën e përbushjes së tyre gjatë periudhës së tillë të shikuar.


Edhe në këtë rast duhet theksuar se të dhënat e tilla janë audituar nga ekipi auditues i ZRRUM-it gjatë kuartalit të dytë të vitit 2010.

Të dhënat grafike do të na tregojnë lëvizjet figurative të këtyre të dhënave nga të cilat mund të nxjerrin konkluzione palët e interesuara.


Diagrami Nr. 6 - Të dhënat e faturuara nga shërbimet e furnizimit me ujë




Diagrami Nr. 7 - Të hyrat e inkasuara nga shërbimet e furnizimit me ujë



Diagrami Nr. 8 - Të hyrat e faturuara nga shërbimet e ujërave të zeza



Diagrami Nr. 9 Të hyrat e inkasuara nga ujërat e zeza



4.3.3. FATURIMI DHE INKASIMI NË NIVEL TË SEKTORIT

Edhe në këtë rast do të shikojmë dhe bëjmë krahasimet e nevojshme sektoriale në mes të shumave të faturimit dhe të inkasimit për periudhat e shikuara kohore të vitit 2008 dhe atë të së njëjtës periudhë të vitit 2009.

Të dhënat e tilla dëshmojnë theksimet tona të lartë cekura se synimet e kompanive kanë qenë tejet ambicioze dhe mbi mundësit reale për tu përmbushur me angazhimin aktual të personelit dhe rrethit në të cilin veprojnë.

Këtë e theksojmë për faktin se është planifikuar një ngritje e shumës së faturimit gjatë vitit 2009 për 21.71% dhe inkasimit për 29.74% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2008.

Të dhënat sektoriale tregojnë se shuma e faturimit dhe inkasimit ka qenë më e ulët sesa shuma e caqeve të përcaktuara me procesin rregullator 2009 për këto dy të dhëna, për faktin se;



- shuma e faturimit ishte më e ulët se ajo e përcaktuar si cak me procesin tariforë për vitin 2009 për 16,58%, dhe
- shuma e inkasimit ishte e pa përmbushur sipas procesit tariforë të përcaktuar si cak me procesin tariforë për vitin 2009 për 23,56%.

Që të gjitha kompanitë i pret një punë e madhe që ti arrijnë caqet e përcaktuara me procesin rregullatorë të tarifave për dy vitet e mbetura dhe mos përmbushja e tillë sigurisht se do të këtë ndikim edhe në mos realizimin e planeve të shërbimit të akorduar mes kompanive dhe DFTRR/ZRRUM për këtë periudhë afatmesme.

Kjo përvojë duhet të na shërbejë edhe si udhërrëfyes se sa është me rëndësi me qenë realist në planifikimet tona të cilat sigurisht se duhet të jenë të bazuara me të dhëna reale.

Për ta ndryshuar këtë gjendje KRU-të duhet të angazhohen për të përmirësuar performancën e vetë, përndryshe reperkusionet janë të pa evitueshme nëse diçka nuk ndryshohet gjatë viteve në vijim.

Të dhënat sektoriale të faturimit dhe inkasimit për vitet 2008 dhe 2009



**TË DHËNAT DHE GJETJET PËR
PROJEKTET
E INVESTIMEVE KAPITALE**

4.4. ANALIZA E INVESTIMEVE KAPITALE

Sektori i ujërave në Kosovë, i takon sektorëve të cilët kanë numër të madh të projekteve që presin për tu realizuar në vitet në vijim. Në dekadën e fundit shumë donatorë kanë dhënë donacione për rehabilitimin dhe ngritje të infrastrukturës ujore në përgjithësi.

Pasi që vendi në periudhën e pas luftës së fundit kishte trashëguar një infrastrukturë ujore shumë të dëmtuar dhe me një përqindje të vogël të mbulushmrisë së popullatës me ujë të pijes dhe rrjetë të pa mjaftueshëm të kanalizimit dhe me as një impiant për trajtim të ujërave të zeza, vërteton konstatimin se ky sektor ka nevoja të mëdha për investime në sigurimin e burimeve të ujit, zëvendësimin e rrjetit të vjetruar të ujësjellësit dhe kanalizimit, zgjerimin e zonave të shërbimit për të gjithë banorët e Republikës së Kosovës dhe fillimin e trajtimit të ujërave të zeza duke ngritë kapacitete të tilla.

Duke pasur parasysh këtë fakt, ZRRUM me tarifat e procesit rregullatorë të viteve 2009 -2011, ka mbështet synimet e tilla për investime të konsiderueshme nga të gjitha kompanitë e ujësjellësit dhe kanalizimit, investime këto shumë të domosdoshme për këtë shërbim jetikë.

Prandaj, DFTRR/ZRRUM i ka kushtuar një pjesë të madhe të angazhimit të tij gjatë vitit 2009 monitorimit sistematik të efekteve të dala nga tarifat e përcaktuara për vitin e shikuar, duke shqyrtuar në veçanti dinamikën e realizimit të projekteve investive kapitale.

Sipas metodologjisë së re tarifore DFTRR/ZRRUM Investimet Kapitale i ka klasifikuar si investime në **shërbimet ujësjellësit** dhe **shërbimet e kanalizimit**. Më pastaj, investimet në asetet e ujësjellësit dhe kanalizimit janë ndarë në: **asetet e infrastrukturës** dhe **ato të jo-infrastrukturës**

Investimet kapitale në **Asetet Infrastrukturore** janë të ndara në investime të cilat bëhen për qëllime të zëvendësimit të infrastrukturës dhe në investime të zgjerimit të infrastrukturës. Këto Investime karakterizohen si investime në asete nëntokësore siç janë: gypat, pusetat, digat, rezervuarët nëntokësore, kanalet e ujit etj.

Investimet kapitale në **Asetet Jo-Infrastrukturore** bëjnë pjesë të gjitha asetet mbitokësore siç janë: fabrikat për trajtimin e ujit, ndërtesat administrative, mjetet transportuese, pajisjet për zyrë etj.

Bazuar në atë që u theksuar ma lartë edhe Tabela Nr. 4., është kategorizuar për dy llojet e shërbimeve; shërbimet e ujësjellësit dhe shërbimet e kanalizimit, të cilat janë ndarë në asetet infrastrukturore dhe jo-infrastrukturore, pastaj të njëjtat janë definuar edhe për kah forma e planifikuar e financimit, në investime vetjake dhe nga donatorët potencial.

Pas këtyre kategorizimeve DFTRR/ZRRUM për vitin 2009 ka bërë edhe këto pasqyrime, si shumën e projekteve të planifikuara dhe aprovuara nga KRU-të dhe të lejuara nga DFTRR/ZRRUM për realizim nga burimet vetjake të financimit dhe shumën e projekteve të realizuara për këtë përudhë kohore nga ky burim, sikurse që është bërë përshkrim i njëjtë edhe për shumën e projekteve të financuara nga donatorët.

Të dhënat e tilla do të analizohen shkurtimisht dhe do të komentohen me qëllim të ndërmarrjes së masave për përmirësim të gjendjes ekzistuese të shumica e kompanive, pasi që kjo është evidente se treguesit nuk janë të mirë për periudhën e shikuar.

Edhe këto të dhëna po i paraqesim në formë tabelore me qëllim të krahasimit më të lehtë të tyre, të cilat janë marr nga kompanitë dhe pastaj janë audituar nga ekipi auditues i ZRRUM-It gjatë kuartalit të dytë të vitit 2010.

Tabela Nr. 4 Investimet Kapitale të planifikuara, të lejuara nga DFTRR/ZRRUM dhe të realizuara nga Kompanitë gjatë vitit 2009

Emri Kompanisë	Kategoria e Investimeve	Investimet Kapitale të planifikuara për Ujë			Investimet kapitale të planifikuara për Kanalizim			Shuma e Investimeve të planifikuara nga kompania për 2009 €	Investimeve vetanake të lejuara me tarifen e vitit 2009 €	Investimet e realizuara gjatë vitit 2009 për Ujë		Investimet e realizuara gjatë vitit 2009 për Kanalizim	
		Vetanake €	Donacione €	Totali €	Vetanake €	Donacione €	Totali €			Vetanake €	Donacione €	Vetanake €	Donacione €
"Prishtina" Sh.A. Prishtinë	Infrastrukturë	1,159,600	6,629,000	7,788,600	152,000	-	152,000	7,940,600	1,679,746	411,379.08	178,256.61	80,783.60	-
	Jo-Infrastrukturë	1,315,800	7,840,000	9,155,800	216,900	1,698,200	1,915,100	11,070,900		204,741.53	112,143.23	-	-
	Totali	2,475,400	14,469,000	16,944,400	368,900	1,698,200	2,067,100	19,011,500		616,120.61	290,399.84	80,783.60	-
"Mitrovica" Sh.A. Mitrovicë	Infrastrukturë	210,850	312,800	523,650	8,700	71,700	80,400	604,050	268,132	-	56,049.50	-	-
	Jo-Infrastrukturë	512,100	139,000	651,100	9,300	-	9,300	660,400		-	346,000.00	-	43,848.00
	Totali	722,950	451,800	1,174,750	18,000	71,700	89,700	1,264,450		-	402,049.50	-	43,848.00
"Hidrodrini" Sh.A. Pejë	Infrastrukturë	452,000	410,000	862,000	19,000	-	19,000	881,000	352,766	105,140.03	33,816.43	750.00	-
	Jo-Infrastrukturë	170,500	60,000	230,500	15,000	-	15,000	245,500		27,383.92	-	-	-
	Totali	622,500	470,000	1,092,500	34,000	-	34,000	1,126,500		132,523.95	33,816.43	750.00	-
"Hidrosistemi Radoniqi" Sh.A. Gjakovë	Infrastrukturë	133,000	252,000	385,000	57,675	376,700	434,375	819,375	957,050	12,319.42	140,139.77	-	-
	Jo-Infrastrukturë	600,000	1,650,000	2,250,000	-	-	-	2,250,000		-	86,583.62	-	-
	Totali	733,000	1,902,000	2,635,000	57,675	376,700	434,375	3,069,375		12,319.42	226,723.39	-	-
"Hidroregjioni Jugor" Sh.A. Prizren	Infrastrukturë	260,800	1,555,894	1,816,694	197,200	5,250,000	5,447,200	7,263,894	383,810	31,566.60	178,404.00	10,500.00	-
	Jo-Infrastrukturë	244,800	1,500,332	1,745,132	50,000	5,000,000	5,050,000	6,795,132		52,475.00	50,923.00	-	-
	Totali	505,600	3,056,226	3,561,826	247,200	10,250,000	10,497,200	14,059,026		84,041.60	229,327.00	10,500.00	-
"Bifurkacioni" Sh.A. Ferizaj	Infrastrukturë	492,000	425,000	917,000	218,800	-	218,800	1,135,800	663,012	24,401.47	505,422.27	4,036.25	309,312.10
	Jo-Infrastrukturë	252,000	-	252,000	43,200	-	43,200	295,200		12,017.81	21,206.17	431.09	-
	Totali	744,000	425,000	1,169,000	262,000	-	262,000	1,431,000		36,419.28	526,628.44	4,467.34	309,312.10
"Hidromorava" Sh.A. Gjilan	Infrastrukturë	25,000	390,000	415,000	25,000	-	25,000	440,000	93,016	-	-	-	-
	Jo-Infrastrukturë	332,600	180,000	512,600	-	-	-	512,600		3,174.20	109,536.98	-	59,500.00
	Totali	357,600	570,000	927,600	25,000	-	25,000	952,600		3,174.20	109,536.98	-	59,500.00
Totali i investimeve	6,161,050	21,344,026	27,505,076	1,012,775	12,396,600	13,409,375	40,914,451	4,397,531	884,599.06	1,818,481.58	96,500.94	412,660.10	

4.4.1 INVESTIMET KAIPTALE SIPAS KRU-ve

- **KRU "PRISHTINA" Sh. A. Prishtinë**

Në marrëveshje të përbashkët KRU "Prishtina" Sh. A. Prishtinë dhe DFTRR/ZRRUM ishin aprovuar një numër i madh i projekteve (edhe pse jo të gjithë) për realizim gjatë vlefshmërisë së tarifave të vitit 2009. Një numër ma i vogël i projekteve kapitale investive ishin planifikuar të financohen nga mjetet vetanake financiare, ndërsa shumica e pjesës tjetër nga donatorët e mundshme.

Në mungesë të mjeteve financiare vetanake dhe procedurave tjera të parapara të cilat nuk ishin përmbush, kompania vetëm pjesërisht ka realizuar projektet e planifikuara me investime vetanake. Ndërsa duhet theksuar se vetëm një shumë minimale e investimeve kapitale të planifikuara me financim të donatorëve ishte realizuar. Të dhënat e tilla do të përshkruhen në vijim të kësaj analize.

DFTRR/ZRRUM me tarifën e procesit rregullatorë të vitit 2009 ka lejuar një shumë dukshëm më të vogël të investimeve të planifikuara nga kompania me financim vetanake financiarë për të dy shërbimet (ujë dhe kanalizim) të cilat ishin kalkuluar në tarifën e vitit 2009. Shprehur në % shuma e projekteve të tilla të aprovuar nga ky burim i investimeve do të mund të arrijë shumën e planifikuar të investimeve nga kompania prej vetëm 59,06%, nëse përmbushen parametrat e planifikuar të këtij viti afarist, të cilat janë inkuorporuar në tarifën e këtij procesi rregullatorë të përcaktuara si objektive për realizim.

Ndërsa, rregullatori gjithë shumën e projekteve të planifikuara për realizim me financim të donatorëve potencial në shumë prej 16,167.200 € e ka aprovuar, por fatkeqësisht vetëm 1.8% të shumës së aprovuar është realizuar e cila shprehur në vlerë absolute arrijë në 290.399 €.

Kur analizohen të dhënat e raportuara dhe ato të gjetura nga auditimi i të dhënave që i ka bërë ZRRUM-i për vitin 2009, shohim se nga investimet e lejuara në të dy shërbimet, nga burimet e brendshme të financimit, kjo kompani ka realizuar vetëm 41,49% të shumës së investimeve. Kur të njëjtat shikohen sipas llojit të shërbimit atëherë kemi këto të dhëna;

- % e realizimit të investimeve nga burimet vetanake të financimit në sektorë të ujit ishte 36,65%, dhe
- % e realizimit të investimeve nga burimet vetanake të financuara në sektorin e ujërave të zeza ishte vetëm 4,81%

Nga këto të dhëna del se kompania as për së afërmi si ka përmbush obligimet e veta të marra për sa i përket treguesve të theksuar më lartë edhe pse kanë qenë të informuara me kohë për trendin e tyre dhe pasojat që mund të dalin nga mos përmbushja dhe mos realizimi i caqeve të përcaktuara me procesin e tarifave të vitit të shikuar për këtë grupim të dhënave.

Viti 2009 nga aspekti i mos realizimit të projekteve investive nuk duhet të përsëritet gjatë vitit 2010 e as atij 2011, pasi që DFTRR/ZRRUM sërish do të monitorojë për së afërmi shumën e projekteve të tilla të aprovuara dhe realizuara, duke nxjerrë konkluzionet e duhura për to, të cilat do të qojnë tek rishikimi i tarifave të vitit pasues tariforë.

- **KRU "MITROVICA" Sh. A. Mitrovicë**

Edhe kjo kompani kishte planifikuar një shumë relativisht të lartë të investimeve për tu realizuar gjatë vitit 2009 për mundësit e veta, nga burimet e veta financiare dhe një shumë të caktuar të investimeve nga donatorët e mundshëm.

Nga shuma e planifikuar e kësaj kompanie për investime kapitale me burime të brendshme financimi për vitin 2009, DFTRR/ZRRUM e kishte aprovuar shumën prej vetëm 36,19% të investimeve të tilla të planifikuar, në pamundësi për tu mbuluar me kosto gjatë procesit rregullatorë të vitit 2009, si dhe një numër të caktuar të projekteve kapitale me financim nga donatorët e mundshëm.

Nga shuma e investimeve të aprovuara për realizim nga mjetet e brendshme vetanake të cilat e kanë ngarkuar tarifën e vitit tariforë 2009, kompania nuk e ka realizuar asnjë projekt, as për shërbimet e ujit e as për ato të kanalizimit për të njëjtin vit.

Ndërsa, shuma e projekteve të planifikuara për realizim nga donatorët e mundshëm gjatë vitit 2009 ishte realizuar në masën prej 85,18% e që konsiderohet si sukses.

Nga këto të dhëna del se kompania nuk e ka realizuar asnjë projekt të investimeve kapitale nga burimet e brendshme financiare edhe pse e njëjta ka qenë e informuar me kohë për trendin e tyre dhe pasojat që mund të dalin nga mos përbushje dhe mos realizimi i caqeve të përcaktuara me procesin e tarifave të vitit të shikuar.

Viti 2009 nga aspekti i mos realizimit të projekteve investive nuk duhet të përsëritet gjatë vitit 2010 dhe 2011, pasi që DFTRR/ZRRUM serish do të monitorojë për së afërmi shumën e projekteve të tilla të aprovuara dhe realizuara duke nxjerrë konkluzionet e duhura për to, të cilat do të qojnë tek rishikimi i tarifave të vitit pasues tariforë.

- **KRU "HIDRODRINI" Sh. A. Pejë**

Me procesin rregullatorë të vitit 2009 edhe kjo kompani kishte planifikuar një numër të caktuar të projekteve kapitale për realizim të cilat të njëjtat DFTRR/ZRRUM i kishte aprovuar për realizim në një shumë ma të vogël se sa ajo që ishte propozuar nga kompania me financim vetanak.

DFTRR/ZRRUM me tarifën e procesit rregullatorë të vitit 2009 ka lejuar një shumë dukshëm më të vogël të investimeve të planifikuara nga kompania për financim nga burimet e brendshme financiare për të dy shërbimet (ujë dhe kanalizim), të cilat i kanë ngarkuar tarifën e vitit tariforë. Shprehur në % shuma e projekteve të tilla të aprovuara nga ky burim i investimeve do të mund të arrijnë shumën e planifikuar të investimeve prej 53,73%, nëse përbushen parametrat e planifikuar siç është me treguesit e tillë të përcaktuar gjatë këtij viti afarist, të cilat janë inkuorporuar në tarifën e vitit 2009.

Në mungesë të mjeteve financiare vetanake dhe procedurave tjera të parapara të cilat nuk ishin përbushur, kompania vetëm pjesërisht ka realizuar projektet e planifikuara me investime vetanake.

Kur analizohen të dhënat e raportuara dhe ato të gjetura nga auditimi i të dhënave që i ka bërë ZRRUM-i për vitin 2009, shohim se investimet nga burimet vetanake të financimit të lejuara në të dy shërbimet, kompania i ka realizuar vetëm 37.78% të shumës së investimeve të tilla.

Kur të njëjtat shikohen sipas llojit të shërbimit atëherë kemi këto të dhëna;

- % e realizimit të investimeve nga burimet vetanake të financimit në sektorë të ujit ishte 37.75%, dhe
- % e realizimit të investimeve nga burimet vetanake të financuara në sektorin e ujërave të zeza ishte vetëm 0,21%

Ndërsa, projektet e planifikuara për realizim nga donatorët e mundshëm janë realizuar vetëm për 7,19% e që është më pak se 1/10 e shumës së projekteve të planifikuara për realizim gjatë vitit afarist 2009.

Nga këto të dhëna del se kompania as për së afërmi si ka përbush obligimet e veta të marra për sa i përket treguesve të theksuar më lartë edhe pse ka qenë e informuar me kohë për trendin e tyre dhe pasojat që mund të dalin nga mos përbushja dhe mos realizimi i caqeve të përcaktuara me procesin e tarifave të vitit të shikuar. Shuma e investimeve të ujërat e zeza është simbolike dhe nuk paraqet ndonjë ndryshim në konkluzionin e dhënë më parë.

Viti 2009 nga aspekti i mos realizimit të projekteve investive nuk duhet të përsëritet gjatë vitit 2010 dhe 2011, pasi që DFTRR/ZRRUM sërish do të monitorojë për së afërmi shumën e projekteve të tilla të aprovuara dhe realizuara duke nxjerrë konkluzionet e duhura për to, të cilat do të qojnë tek rishikimi i tarifave të vitit pasues taritorë.

- **KRU "RADONIQI" Sh. A. Gjakovë**

Kësaj kompanie, DFTRR/ZRRUM i ka lejuar një shumë më të lartë të investimeve të planifikuara për financim nga mjetet e brendshme financiare gjatë vitit 2009 që të arrijë ngritjen më të lartë të tarifës dhe nga shuma e kërkuar prej këtij burimi në lartësi prej 790.675€, DFTRR/ZRRUM të njëjtën e ka ngrit në 957.050€. Si shumë e mundshme për realizim gjatë vlefshmërisë së tarifave të vitit 2009 nga ana e kompanisë, për të dy shërbimet që i ofron. Kjo ngritje shprehur në % për 21.04 % ma e lartë se shuma e propozuar nga kompania me aplikacionin taritorë..

Në mungesë të mjeteve financiare vetanake dhe procedurave tjera të parapara të cilat nuk ishin përbush, kompania vetëm pjesërisht ka realizuar projektet e planifikuara me investime vetanake.

Ndërsa, projektet e planifikuara për realizim nga donatorët e mundshëm janë aprovuar në shumën e planifikuar e cila ishte realizuar në masën prej vetëm 9,95% e që është më pak se 1/10 e shumës së projekteve të planifikuar për realizim gjatë vitit afarist 2009.

Kur analizohen të dhënat e raportuara dhe ato të gjetura nga auditimi i të dhënave që i ka bërë ZRRUM-i për vitin 2009, shohim se nga investimet vetanake të planifikuara në të dy shërbimet, kompania i ka realizuar vetëm 1,29% të shumës së investimeve të aprovuara. Kjo shumë ka të bëjë vetëm me investimet në shërbimet ujit e as një investim nuk është realizuar në shërbimin ujërave të zeza gjatë vitit 2009.

Nga këto të dhëna del se kompania as për së afërmi si ka përbush obligimet e veta të marra për sa i përket treguesve të theksuar më lartë edhe pse e njëjta ka qenë e informuar me kohë për trendin e tyre dhe pasojat që mund të dalin nga mos përbushja dhe mos realizimi i caqeve të përcaktuara me procesin e tarifave të vitit të shikuar.

Viti 2009 nga aspekti i mos realizimit të projekteve investive nuk duhet të përsëritet gjatë vitit 2010 dhe 2011, pasi që DFTRR/ZRRUM sërish do të monitorojë për së afërmi shumën e projekteve të tilla

të aprovuara dhe do të nxjerrë konkluzionet e duhura për to, të cilat do të qojnë tek rishikimi i tarifave të vitit pasues tariforë.

- **KRU "HIDROREGJIONI - JUGOR" Sh. A. Prizren**

Me procesin rregullatorë të vitit 2009 edhe kjo kompani kishte planifikuar për realizim një shumë të caktuar të projekteve kapitale për të dy shërbimet, nga dy burime të financimeve, të cilat konsideroheshin si tejet ambicioze dhe vështirë të realizueshme gjatë vitit të kaluar nga DFTRR/ZRRUM.

Nga analizat dhe llogaritjet e bëra, rregullatori ka konkluduar se shuma e kërkuar për realizim të projekteve investive për të dy shërbimet e ofruara nga kompania nga burimet veta të financimit për vitin 2009 është e pamundur të realizohet . Prandaj shumën e propozuar për realizim të projekteve të tilla prej 752.800 €, DFTRR/ZRRUM shumen e tillë e ka zbrit për realizimi vetëm në 383.810 €. Shprehur në % shuma e aprovuar nga rregullatori ishte në masën e saj prej 50,98%. Si shumë e mundshme për realizim gjatë vlefshmërisë së tarifave të vitit 2009 për këtë kompania, për të dy shërbimet e ofruara.

Në mungesë të mjeteve financiare vetanake dhe procedurave tjera të parapara të cilat nuk ishin përbushur, kompania vetëm pjesërisht ka realizuar projektet e planifikuara me investime vetanake.

Kur analizohen të dhënat e raportuara dhe ato të gjetura nga auditimi i të dhënave që i ka bërë ZRRUM-i për vitin 2009, shohim se nga investimet vetanake të aprovuara me procesin rregullatorë të vitit 2009, kompania ka realizuar vetëm 24,63% të shumës së investimeve të tilla. Kur të njëjtat shikohen sipas llojit të shërbimit atëherë kemi këto të dhëna;

- % e realizimit të investimeve nga burimet vetanake të financimit në sektorë të ujit ishte 21,90%, dhe
- % e realizimit të investimeve nga burimet vetanake të financuara në sektorin e ujërave të zeza ishte vetëm 2,74%

Edhe te kjo kompani kemi dështim të plotë të përbushjes së planeve investive me financim nga donatorët e mundshëm, pasi që nga shuma e aprovuar për realizim prej 13,306,226 € në të dy shërbimet e njëjta ka realizuar vetëm 1,72% të shumës së investimeve të tilla.

Nga këto të dhëna del se kompania as për së afërmi si ka përbush obligimet e veta të marra për sa i përket treguesve të theksuar më lartë edhe pse kanë qenë të informuar me kohë për trendin e tyre dhe pasojat që mund të dalin nga mos përbushja dhe mos realizimi i caqeve të përcaktuara me procesin e tarifave të vitit të shikuar.

Viti 2009 nga aspekti i mos realizimit të projekteve investive nuk duhet të përsëritet gjatë vitit 2010 dhe 2011, pasi që DFTRR/ZRRUM sërish do të monitorojë për së afërmi shumën e projekteve të tilla të aprovuara dhe të realizuara duke nxjerrë konkluzionet e duhura për to, të cilat do të qojnë tek rishikimi eventual i tarifave të vitit pasues tariforë.

- **KRU "BIFURKACIONI" Sh. A. Ferizaj**

KRU "Bifurkacioni" Sh. A. Ferizaj, kishte planifikuar për realizim një numër të caktuar të projekteve investive, në një shumë relativisht të lartë për mundësit e veta që i kishte gjatë vitit tariforë 2009 nga mjetet vetanake të investimeve, të cilën DFTRR/ZRRUM e kishte rishikuar gjatë analizave dhe

llogaritjeve të bëra me rastin e përcaktimit të tarifave të procesit rregullatorë të vitit 2009. Projektet e tilla kishin të bënin me të dy shërbimet. Përveç shumës së tillë të investimeve kompania kishte planifikuar edhe një shumë të caktuar të investimeve për realizim nga donatorët potencial të cilën kjo zyrë e kishte aprovuar si të tillë.

Shuma e investimeve vetanake të propozuar nga kompania, DFTRR/ZRRUM pas analizave dhe llogaritjeve të bëra e ka korrigjuar në përputhje me mundësitë që do të mund të krijoheshin kësaj kompanie për realizim vitit 2009, të cilat janë kalkuluar në tarifat e vitit të shikuar. Shprehur në % shumën e projekteve të tilla të aprovuar nga ky burim i planifikuar për investime do të mund të arrinte shumën maksimale të mundshme të tyre prej 65,91%, nëse përmbushen parametrat e planifikuar të këtij viti afarist.

Ndërsa, rregullatori gjithë shumën e projekteve të planifikuara për realizim me financim të donatorëve potencial e ka aprovuar si të tillë. Për fat të mirë dhe të vetëm gjatë vitit 2009 nga të gjitha KRU-të, kjo kompani është e vetmja që ka tejkaluar shumën e tillë të projekteve të realizuar për 96,69%. Shprehur në vlerë absolute duhet theksuar se shumën e aprovuar në fillim vitit nga rregullatori ishte në lartësi prej 425,000 € e cila në fund të vitit 2009 kishte arrit në 835,940 €, falë donacioneve të KK të Ferizajt për renovim të objekteve të infrastrukturës në qytetin e tyre.

Kur analizohen të dhënat e raportuara dhe ato të gjetura nga auditimi i të dhënave që i ka bërë ZRRUM-i për vitin 2009, shohim se nga investimet e lejuara në të dy shërbimet, nga burimet e brendshme të financimit kompania ka realizuar vetëm 6.17% të shumës së investimeve të aprovuara. Kur të njëjtat shikohen sipas llojit të shërbimit atëherë kemi këto të dhëna;

- % e realizimit të investimeve nga burimet vetanake të financimit në sektorë të ujit ishte vetëm 5,49%, dhe
- % e realizimit të investimeve nga burimet vetanake të financuara në sektorin e ujërave të zeza ishte vetëm 0,67%

Nga këto të dhëna del se kompania as për së afërmi nuk i ka përmbush obligimet e veta të marra për sa i përket treguesve të theksuar më lartë edhe pse ka qenë e informuar me kohë për trendin e tyre dhe pasojat që mund të dalin nga mos përmbushje dhe mos realizimi i caqeve të përcaktuara me procesin e tarifave të vitit të shikuar.

Viti 2009 nga aspekti i mos realizimit të projekteve investive nuk duhet të përsëritet gjatë vitit 2010 dhe 2011, pasi që DFTRR/ZRRUM sërish do të monitorojë për së afërmi shumën e projekteve të tilla të aprovuara dhe realizuara duke nxjerrë konkluzionet e duhura për to, të cilat do të qojnë tek rishikimi i tarifave të vitit pasues tariforë.

• **KUR "HIDROMORAVA" Sh. A. Gjilan**

Edhe shumën e investimeve të planifikuara nga burimet vetanake të investimeve nga kjo kompani, DFTRR/ZRRUM e ka korrigjuar për realizim në të dy shërbimet, pasi që e njëjta dukej të ishte dukshëm mbi mundësitë e realizimit të tyre gjatë vlefshmërisë së tarifave të vitit 2009. Si shumë e mundshme për realizim gjatë vlefshmërisë së tarifave të vitit 2009 nga burimet vetanake të financimit të kompanisë, rregullatori kishte identifikuar shumën e mundshme prej 93,016 € e cila shprehur në % arrinte vetëm shumën fillestare të propozuar prej 24,31% për të dy shërbimet që e njëjta i ofron.

Ndërsa, projektet e planifikuara për realizim nga donatorët e mundshëm janë aprovuar në shumën e plotë të tyre dhe shumën e tillë e planifikuar e investimeve kapitale me financim nga donatorët e

mundshëm është realizuar në masën prej vetëm 29,66% e që është më pak se 1/3 e shumës së projekteve të planifikuara për realizim gjatë vitit afarist 2009.

Kur analizohen të dhënat e raportuara dhe ato të gjetura nga auditimi i të dhënave që i ka bërë ZRRUM-i për vitin 2009, shohim se nga investimet vetanake të lejuara në të dy shërbimet, kompania i ka realizuar vetëm një shumë simbolike prej 3.41% të shumës së investimeve të aprovuara.

Kjo shumë ka të bëjë vetëm me investimet në shërbimet ujit e as një investim nuk është realizuar në shërbimin ujërave të zeza gjatë vitit 2009.

Nga këto të dhëna del se kompania as për së afërmi si ka përmbush obligimet e veta të marra për sa i përket të dhënave të theksuar më lartë edhe pse ka qenë e informuar me kohë për trendin e tyre dhe pasojat që mund të dalin nga mos përmbushja dhe mos realizimi i caqeve të përcaktuara me procesin e tarifave të vitit të shikuar. Shuma e investimeve të ujërat e zeza është simbolike dhe nuk paraqet ndonjë ndryshim në konkluzionin e dhënë më parë.

Viti 2009 nga aspekti i mos realizimit të projekteve investive nuk duhet të përsëritet gjatë vitit 2010 dhe 2011, pasi që DFTRR/ZRRUM sërish do të monitorojë për së afërmi shumën e projekteve të tilla të aprovuara duke nxjerrë konkluzionet e duhura për to, të cilat do të qojnë tek rishikimi i tarifave të vitit pasues tariforë.

4.4.2. TË DHËNAT SEKTORIALE TË PËRGJITHSHME PËR INVESTIME KAPITALE

Kur shikohen këto të dhëna nga aspekti historik afatshkurtër mund të thuhet se për herë të parë kompanive u janë krijuar parakushtet që të fillojnë të krijojnë fitime të caktuara nga afarizmi i tyre dhe me to të realizojnë projektet e caktuara, të cilat relativisht janë të vogla në përputhje me nevojat që sektori i ka.

Shuma e projekteve investive të planifikuara për financim nga burimet vetanake nga shtatë KRU-të për vitin 2009 ishte planifikuar të arrinte vlerën prej 7.173.825€, të cilën ZRRUM e ka korrigjuar duke e sjellë në shumë të përgjithshme prej 4.397.531€ e cila shprehur në % është 61,30% nga shumata fillimisht e planifikuar e cila do të mund të mbulohej me tarifën e viti 2009.

Nga gjithë kjo shumë e lejuar janë realizuar vetëm 981,099€ ose shprehur në (%) vetëm 22,31% e që as për së afërmi s'është e mjaftueshme për të realizuar synimet e pritshme.

Kur të njëjtat shikohen sipas llojit të shërbimit atëherë kemi këto të dhëna;



- % e realizimit të investimeve nga burimet vetanake të financimit në sektorë të ujit ishte vetëm 20,12%, dhe
- % e realizimit të investimeve nga burimet vetanake të financuara në sektorin e ujërave të zeza ishte vetëm 2,19%

Të dhënat e tilla dëshmojnë për mos përmbushjen e caqeve të përcaktuara me procesin rregullatorë të vitit 2009 edhe për këto të dhëna të KRU-ve të cilat iu janë nënshtruar procesit rregullatorë të vitit 2009.

Shuma e planifikuar e projekteve dhe investimeve me financim të mundshëm nga donatorët potencial ishte paramenduar se do të arrinte në 33,740,626 € e cila gjatë vitit të shikuar ishte realizuar në shumën prej vetëm 2,231,141 € e cila shprehur në % del të jetë realizuar vetëm 6,61% të shumës së planifikuar për realizim gjatë vitit 2009.

Manaxhmentet dhe palët tjera të interesit të këtij sektori duhet të intensifikojnë angazhimin e tyre për realizim të planeve të tyre operative dhe financiare të përcaktuara si objektive gjatë dy viteve tarifore të mbetura të kësaj periudhe, të viteve 2010 dhe 2011 të procesit tariforë 2009 – 2011, pasi që sektori mund të bie në vështirësi në të ardhmen dhe do të ulë vlerën e asetëve të veta nga mos investimi i mjeteve të veta financiare.

Realizimi i planeve operativo – financiare të përcaktuara si cak gjatë viteve 2010 dhe 2011 gjer në fund të viteve të shikuara është parakusht për realizim të investimeve nga burimet financiare vetanake.



5. KONKLUZIONET DHE REKOMANDIME

Ekipi i DFTRR/ZRRUM-it gjatë vizitave të realizuara nëpër kompani me qëllim të përgatitjes dhe punimit të këtij raporti, është prit mjaft mirë nga KRU-të dhe mund të konstatohet se ka pas një përmirësim në gatishmërinë e shprehur nga stafet bashkëpunuese të tyre për të ofruar dhe sqaruar të dhënat e kërkuara, në krahasim me takimet e mëparshme të mbajtura për këtë qëllim.

Kjo vlerësohet nga ZRRUM si një qasje pozitive dhe bashkëpunuese e KRU-ve të cilat kanë ofruar të gjitha të dhënat që i kishin në dispozicion në momentin e realizimit të vizitave.

Që të gjitha kompanitë kanë dështuar në përbushjen e caqeve të përcaktuara. Edhe ato tri kompani, si 'Prishtina', 'Mitrovica' e 'Hidroregjioni Jugor', që kanë përbush objektivin e përcaktuar të prodhimit të ujit, që të gjithë treguesit tjerë janë nën caqet e përcaktuara, kështu sasia e ujit të prodhuar është më negative se mos me e pas prodhuar sasinë e tillë shtesë fare. Kjo ndërlidhet me faktin se humbjet e ujit janë më të mëdha, faturimi ujit dhe ujërave të zeza është më i ulët etj.

Dështime të theksuara ka edhe tek faturimi i ujit të prodhuar për këtë periudhë kohore të shikuar, pastaj edhe sasia e grumbullimit të ujërave të zeza ma e ulët etj. Kur i shikojmë të dhënat e tilla të vitit 2008 dhe i krahasojmë të njëjtat me vitin e përmbyllur tani 2009, do të shohim se parametrat e prodhimit të ujit tek disa kompani janë përbush e te disa të tjera jo, edhe ta faturimi kemi të njëjtin rast te disa kompani kemi faturimin sasior më të ulët se sa faturimet e tilla të vitit 2008 e te disa kemi ngritje. Sikurse që është rasti edhe te grumbullimi sasior i ujërave të zeza.

Objektivat e përcaktuar për shumën sasiore të faturimit të ujit gjatë vitit 2009 ishte më e ulët për 13,74% dhe ajo e ujërave të zeza për 10,22%.

Pa hy në strukturën shpenzimeve operative për shërbimet e ofruara të ujit dhe kanalizimit gjatë vitit tariforë 2009 të cilat ishin caktuar si cak, që të gjitha kompanitë mund të grupohen në dy grupe;

- kompanitë që kanë shpenzuar më pak se shuma e aprovuar me procesin rregullatorë për vitin e shikuar janë; "Prishtina", "Mitrovica", "Bifurkacioni" dhe "Hidromorava" dhe sektori në përgjithësi,
- ndërsa kompanitë që kanë tejkalluar shpenzimet e tilla të aprovuara me procesin e përmendur rregullatorë, janë; "Hidrodrini", "Radoniqi" dhe "Hidroregjioni Jugor", dhe
- edhe numri i konsumatorëve të faturuar për shërbimin e ujit është ngritë për 11,70% dhe te ata të kanalizimit për 12,24%, që konsiderohet një sukses i vlefshëm për tu përmendë.

Në përgjithësi duhet theksuar se shuma e shpenzimeve të përgjithshme të sektorit është më e ulët për 0,89% nga shuma e aprovuar si cak me procesin rregullatorë për vitin 2009, por në esencë është më e lartë se shuma e treguesve tjerë që nuk janë përbush për të njëjtën periudhë kohore. Është e domosdoshëm që zërat e këtyre shpenzimeve në të ardhmen të racionalizohen dhe të sillen në proporcion me efektet e përmirësuar financiare të cilat duhet arritur.

Shpenzimet për paga dhe për energjinë elektrike janë tejkalluar dukshëm tek të gjitha KRU-të, me disa përjashtime.

KRU-të duhet të angazhohen në ndërrimin e këtij disproporcioni të shpenzimeve të bëra për zëra të caktuara të shpenzimeve, duke zvogëluar fondin e pagave dhe ngritur shumën e shpenzimeve për riparime dhe mirëmbajtje kapitale të rrjetit të shërbimeve dhe aseteve të tjera, nëse nuk veprohet kështu vlera e aseteve detyrimisht do të ulët e kjo do të ishte e pa pranueshme.

Edhe të dhënat e faturimit dhe inkasimit nga aspekti monetar janë edhe më të pa favorshëm, pasi që të gjitha kompanitë pa përjashtim kanë dështuar ti përmbushin caqet e përcaktuara të shumave të tilla të cilat ishin aprovuar me procesin rregullatorë të vitit 2009.

Të dhënat sektoriale për këtë grupim tregojnë fatin e tillë për të gjitha kompanitë, të cilat në dy vitet e ardhshme pa shmangshëm duhen përmirësuar, përndryshe humb kuptimi i përmirësimit ekonomik i vet kompanive.

Efektet financiare të ngritura nga një periudhë kohore të një procesi rregullatorë tek tjetri duhet të jetë i pa shmangshëm, përndryshe pasojat evidente do të mund të shihen që nga ulja e nivelit të shërbimit, jo racionalizimit ekonomik, ulja vlerës së asetëve, jo qëndrueshmëria eventuale financiare etj.

Dështim i madh shihet të ketë ndodhur te realizimi i projekteve investive kapitale të planifikuara, te të dy burimet e financimit të investimeve dhe kjo duhet të jetë brengosëse për të gjitha palët e interesuara të këtij sektori.

Theks të veçantë i japim realizimit të projekteve nga burimet financiare vetjake të kompanive të cilat janë të ndërlidhura me realizim të të gjithë parametrave të përcaktuar si cak gjatë vitit 2009 me procesin rregullatorë të vitit të shikuar, qoftë nga financimet vetanake të vet kompanive, qoftë nga projektet kapitale të planifikuara për realizim me financim të donatorëve potencial.

Aspektet përmbledhëse

Angazhimin e ekipit të DFTRR-së në realizim të kësaj pune dhe aktivitetet tjera të ndërlidhura me të, e konsiderojmë si eksperiencë të mirë dhe të suksesshme. Nga kjo punë është fituar një përvojë e re e cila do të na ndihmojë për të konsoliduar të dhënat e nxjerra edhe gjatë periudhave dhe viteve pasuese, sikurse që do të na ndihmojë ti sqarojmë disa çështje esenciale me përfaqësuesit e kompanive për këtë vit dhe për vitet tjera pasuese.

Angazhimi i tillë do të na ndihmojë edhe në riorganizim dhe rishikim eventual të politikave të reja për të ardhmen, duke përcaktuar si prioritet këmbënguljen e përmirësimit të gjendjes së këtij sektori i cili është jetik për popullin.

Të gjithë individët në ZRRUM, kompani dhe jashtë tyre janë ftuar që të bëjnë komentet e tyre pa hezitim, me qëllim korigjimi eventual të dhënave të pasqyruara, ose të sugjerojnë plotësimin e tij me të dhëna tjera eventuale të cilat mund të mos jenë marrë në konsideratë ose neglizhuar nga DFTRR/ZRRUM pa qëllim tij.

*Në afatin e dhënë kompanive për të bërë komentet e tyre eventuale i cili ka qenë theksuar si datë e fundit, e **martë, 17 gusht 2009** i është përgjigj pjesërisht vetëm KRU "Bifurkacioni" sh. a. Ferizaj e cila kërkesat e veta të pjesshme nuk i ka qua deri në fund, pasi që nuk i ka ofrua të dhënat e kërkuara nga rregullatori. Korrespondenca e jonë me këtë kompani është përmbyllë sipas teksteve të shkruara nga të dyja palët i cili i është bashkëngjitur këtij raporti nga faqja 54 gjerë te faqja 56.*

Falënderojmë gjithë ata që kanë kontribuar në përpilimin e këtij Raporti të Parë Vjetorë të këtij formati i cili vlerëson përbushjen e objektivave të përcaktuara me procesin rregullatorë të vitit 2009.

Prishtinë, 9 gusht 2010

Përgatitur nga: DFTRR/ZRRUM

**SHTOJCA A:
PROCESI I KONSULTIMEVE ME KRU-të
PËR
TË DHËNAT DHE GJETJET E RAPOTIT**

Me qëllim të evitimit të mangësive eventuale dhe pasaktësive me rastin e përpilimit të këtij raporti, ZRRUM ka zhvilluar një proces të konsultimit me KRU-të duke kërkuar komentet e tyre në draftin e parë të raportit para se i njëjti të finalizohet.

Komentet e KRU-ve dhe përgjigjet e ZRRUM në të njëjtat janë dhënë në vijim me qëllim sqarimi të çështjeve të ngritura nga KRU-të.

1. Dërgimi i Draft Raportit për Komente nga KRU-të

From: Sami Hasani [mailto:sami.hasani@wwro-ks.org]

Sent: Monday, August 09, 2010 4:12 PM

To: 'Skender Bublaku'; 'Naim Mujaj'; 'a tigani'; r.maloku@hidrodrini.com; 'Faruk Hajrizi'; meha-profi@live.com; besimbaraliu@live.com; 'mirlinda 2002'; 'fatn frangu'; info@bifurkacioni.com; albert_zajmi@yahoo.com; 'Kastriot Zhaveli'; myrvetej@yahoo.com; xhelal_shabani@yahoo.com

Cc: raif.preteni@wwro-ks.org; kero.bardhaj@wwro-ks.org; 'Vehbi Duraku'; hysni.feka@wwro-ks.org

Subject: FW: Raport Vjetor për caqet e përcaktuara me tarifat e vitit 2009

Zonja /Zotërinj të nderuar,

Të bashkangjitur në këtë e-mail do të gjeni versionin ende punues të

- **Raportit Vjetor të Caqeve të Përbushura me Procesin Tariforë të vitit 2009**

nga të gjitha kompanitë e licencuara nga ZRRUM.

Këtë version të Raportit e kemi quajt punues pasi që u epet mundësia të gjitha kompanive të epin komentet e tyre në përmbajtjen e tij para se i njëjti ta merr formën përfundimtare.

Përveç, komenteve eventuale që mund ti epni, ne do të mund ti inkorporojmë në tekst edhe dy tri grafikone, pa e ndryshuar esncialisht përmbajtjen e tekstit.

Do të mirëpresim çdo komentim tuajin, për të cilat do të mund të diskutonim në çdo moment të përshtatshëm për të dy palët, me akordim paraprak.

Përparësi absolute do të kenë të dhënat tuaj të cilat mund të mos jenë marrë në konsideratë nga ZRRUM për këtë analizë e të cilat mund të shtrembërojnë të dhënat e gjetura në këtë raport.

Komentet tuaja i presim gjerë të martën, me **17 gusht 2010**, të cilën e konsiderojmë si datë përmbyllëse, për ta përgatit versionin përfundimtarë të këtij raporti.

Sami Hasani, DFTRR/ZRRUM, Prishtinë

Telefoni i zyrës: (038) 249-165 lokali 120, ose (044) 155-743

2. Komentet e KRU-ve

2.1 Komentet e KRU “ Bifurkacioni” Sh.a - Ferizaj



From: Zelfije Hyseni [mailto:zelfije_hyseni@hotmail.com]
Sent: Tuesday, August 17, 2010 2:13 PM
To: sami.hasani@wwro-ks.org
Subject: Koment rreth raportit PËRMBUSHJEN E CAQEVE TË PËRCAKTUARA ME PROCESIN RREGULLATORË TË VITIT 2009

Përshendetje Z.Hasani.

Me kujdesin më të madh kam lexuar raportin tuaj rreth PËRMBUSHJEN E CAQEVE TË PËRCAKTUARA ME PROCESIN RREGULLATORË TË VITIT 2009 dhe me këtë rast po japi komentimin tonë të përgjithshëm:

Parashikimet tona të 2008 për 2009 janë dhënë duke u bazuar në koplet njesitë përbërëse pra duke përfshirë edhe Njësinë e Kaçanikut, andaj konsideroj se me ndarjen e kësaj njësie edhe parashikimet tona kanë qenë të pa arritshme.

Problemet e paraqitura në vitin 2009 që kanë ndikuar në mos realizimin e parashikimeve po i përblejdhim sipas grupimit të treguesve kryesor.

1. Prodhimi i ujit- Prodhimi i ujit është parashikuar për të dy njesitë si dhe për sasinë e ujit të shtuar me 20 tetor të vitit 2008 si dhe duke u bazuar në sistemet e zonave rurale që kanë sasine e ujit të vlerësuar.
2. Faturimi i ujit-Shtimi i sasisë së ujit në menyrë të menjëhershme ka ndikuar në rritjen e shpenzuesve të paregjistruar e që si proces i identifikimit dhe regjistrimit të tyre ka qenë paksa i ngadalësuar në mungesë të stafit punues në teren. Po ashtu disa ndërrime të bëra në kuadër të shërbimit të konsumatorëve me qëllimin e rritjes së inkasimit (Leximi i UM si dhe inkasimi të behet nga i njëjti person poashtu ngarkesa për në bazë të faturimit për pagat ka ndikuar në uljen e faturimit , e të cilat probleme me kohë janë vërejtur dhe tash janë përmirësuar. E gjitha kjo ka ndikuar edhe në rritjen e hubjeve.
3. Inkasimi - gjendja e veshirë ekonomike , rastet sociale , mos funksionimi i gjykatave e tj. ka ndikuar në mos realizimin synimeve tona edhe pse përpjekjet kanë qenë maksimale.
4. Shpenzimet Operative- Me ndarjen e Njësisë së Kaçanikut si dhe një kujdesi dhe monitorimi me efikas kanë rënë shpenzimet operative por gjithmonë jo në demin e konsumatorëve. Ndërsa shpenzimet e rrymës janë të medha(edhe pas ndarjes së Njësisë së Kaçanikut) ngase shtimi i sasisë së ujit në FPU ka shtuar shpenzimet tjera po edhe të energjisë elektrike (Rritja e numrit të shperlarjve të filtrave e trefishuar- një prej indikatorë të rritjes së shpenzimeve të energjisë). Po ashtu marrja në menaxhimin të sistemeve tjera të zonave rurale ka rritur në masë shpenzimet e rrymës sepse stacionet e pompimit kanë shpenzime të medha të energjisë se rrymës. Në Njësinë e Kaçanikut i gjithë furnizimi i ujit bëhet pa përpunim dhe pa Stacioni pompimi.
5. Shuma e projekteve të planifikuara dhe realizuara gjatë vitit 2009 - Në mungesë të një vlere të përcaktuar për investim kapital (kufiri se prej cilës vlere mund të llogaritet si investim kapital) sa do pak ka ulë regjistrimin vlerës së investimeve kapitale vetanake .

Duke vlerësuar shumë gjykimin tuaj të sigurtë dhe real rreth të arriturave tona si kompani mbës me

shpresë se edhe kësaj here të keni durumin ti shqyrtoni komentet tona.

Me respekt : Zelfije Hyseni

○ **Përgjigjja e ZRRUM në Komentet e KRU "Bifurkacioni" Sh.a – Ferizaj**

From: Sami Hasani [mailto:sami.hasani@wwro-ks.org]

Sent: Wednesday, August 18, 2010 11:22 AM

To: 'Zelfije Hyseni'

Cc: 'Raif Preteni'; 'kero.bardhaj@wwro-ks.org'; 'Vehbi Duraku'; 'hysni.feka@wwro-ks.org'

Subject: RE: Koment rreth raportit PËRMBUSHJEN E CAQEVE TË PËRCAKTUARA ME PROCESIN RREGULLATORË TË VITIT 2009

Zonja Hyseni,

Konfirmojmë pranimin e e-mailit tuaj të djeshëm dhe komentet e bëra në versionin punues të Raportit Vjetorë të Përbushjes së Caqeve të Përcaktuara me procesin tariforë 2009-2011, për vitin 2009.

Përbajtja e e-mailit tuaj është e kuptueshme në shumicën e çështjeve të cilat ju i keni trajtuar, por është dashur që të njëjtat të saktësohen me të dhëna konkrete e jo në formën e dhënë si të përgjithësuar, pasi që për këtë keni pas kohë nga 9 gjerë me 17 gusht me u përgjigj, edhe pse për disa mund të konsiderohen të arsyeshme e disa të tjera jo.

Me qellim shtjellimi të mëtutjeshëm, ne radhazi do ti komentojmë të njëjtat;

- jemi të njoftuar se Njësia e Kaçanikut është shkëput nga rrjeti i juaj i funksionimit dhe do të kishte qenë e domosdoshme me na njoftuar edhe për datën e saktë të shkëputjes së saj,
- për prodhim, shpenzime operative, faturim dhe inkasim qoftë sasiore, qoftë financiare kërkojmë të dhëna të sakta për njësinë e shkëputur, duke llogarit edhe numrin e konsumatorëve dhe numrin e të punësuarve të shkëputura nga ju,
- informatat tuaja për këto çështje i presim gjerë të **premtën, 20 gusht 2010, ora 09,00**, për me i bërë korrigjimet e nevojshme në raport.

Të dhënat e lartë cekuar është dashur të na dërgohen që në momentin e shkëputjes së njësisë për vitin 2009 e të njëjtat të dhëna i kërkojmë edhe për vitin 2010 dhe 2011, për me bë përshtatjet tjera për pasqyrimet tjera vijuese.

Të gjitha çështje tjera të theksuara nga ju, si; zonat rurale të shërbimit, vlera minimalë e llogaritjes së shumave si investime kapitale nuk janë të arsyeshme dhe të njëjtat nuk mund të merren në konsideratë.

Për zonat rurale janë zhvilluar procese të veçanta tarifore dhe të gjitha kostot për të janë marrë parasysh, sikurse që mund ta dine tarifatat e tyre janë më të larta se tarifatat e pjesë tjetër të regjionit, kështu që argumenti i juaj për të njëjtat nuk qëndron.

Ndërsa, për shumën fillestare të llogaritjes si investim kapital (riparim, mirëmbajtje apo investim kapital) dihet dhe departamenti i juaj i financave dhe kontabilitetit do të duhej të njëjtën ta dite e besojë se ashtu veprojnë.

Të themi se çdo shumë mbi vlerën 1.000,00 € të investimeve që bëhet në asetet e kompanisë e që do të zgjatë jetëgjatësinë e asetit nga aspekti i përdorimit të tij, konsiderohet si shpenzim për mirëmbajtje, ose riparim ose investim i rij kapital.

Në formë të përmbledhur komentet tona kanë të bëjnë me faktin se të gjitha të dhënat e cekura për njësinë e shkëputur të Kaçanikut duhet dërguar gjerë në kohën e theksuar ma lartë, me qëllim të marrjes në konsideratë të tyre për korrigjimin e të dhënave në raport, edhe pse besojë se nuk do ti ndryshojë shumë të dhënat e dala.

Ndërsa çështjet tjera të cekura në e-mailin tuaj të djeshëm nuk do të merren në konsideratë pasi që konsiderojmë se të njëjtat nuk janë të bazuara në të dhëna reale.

Nëse, gjerë të premtën në mëngjes nuk i marrim komentet tuaja, ne do të përbyllim këtë raport dhe në te do ti bashkëngjisim komentet tuaj me përgjigjen tonë në te si dëshmi të komunikimit të ndërsjellë.

Ju përshëndes,

Sami Hasani, DFTRR/ZRRUM, Prishtinë

Telefoni i zyrës: (038) 249-165 lokali 120, ose celulari (044) 155-743